

PERËNDIA thotë

Ju falënderojmë për përdorimin e planeve tona të mësimit për shërbesën e adoleshentëve. Nëse dëshironi të keni të gjithë manualin së bashku me materialet për shpërndarje dhe vizualet, plus CD-në me vizualet dhe materialet me ngjyra, ju lutemi kontaktoni zyrën tonë në Durrës për t'i blerë ato. Donacionet e sjella për këto manuale do të na ndihmojnë ne për të përkthyer dhe prodhuar materiale më të mira mësimdhënieje për mësuesit. Perëndia ju bekoftë ndërsa e përdorni literaturën tonë për frymëzimin tuaj në shërbesën e mësimdhënies. Skuadra e BUFSH-së.

Nxitja për të rinjtë



BUFSH

BASHKËSIA E UNGJILLIZIMIT
TË FËMIJËVE E SHQIPËRISË®

PERËNDIA thotë

Manuali fillimisht i përgatitur nga *Bashkësia e Ungjillizimit të Fëmijëve e Irlandës*
Rishikimi: Philippe Mayhew, Marika Muhr and David Crutchley

Faqosja: Brent Hautle

Ilustrimet: Marek Moskor

Përktheu: Leonard Doka

Redaktoi: Irena Sema, Ornela Shuqja

Copyright © 2005 Child Evangelism Fellowship® of Europe

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përdorur me leje.

Mund të riprodhohet vetëm për përdorim personal, shërbese,
jofitimprurës ose jo-komercial. Vizitoni www.teachkids.eu/al
për më shumë detaje mbi lejen e përdorimit.

Citimet e Shkrimit janë marrë nga

version i Biblës në shqip ABS (1991-1994) .

Copyright © 1994 Albanian Bible Society A.B.S

Printed in Albania



BUFESH

BASHKËSIA E UNGJILLIZIMIT
TË FËMIJËVE E SHQIPËRISË®

Bashkësia e Ungjillizimit të Fëmijëve, Shqipëri

Lagja 18; Rruga "Vaso Pasha",

Durrës, Shqipëri

bufshdurrës@gmail.com

Përmbajtja



Hyrja	5
<hr/> Perëndia thotë - Kjo është Fjala Ime	
Mësimi 1 • Pse ta studiosh Biblën?	7
Mësimi 2 • Si ta studiosh Biblën	11
<hr/> Perëndia thotë - Këto janë standardet e mia	
Mësimi 3 • Urdhërimi i parë dhe i dytë	15
Mësimi 4 • Urdhërimi i tretë dhe i katërt	19
Mësimi 5 • Urdhërimi i pestë, i gjashtë, i shtatë	23
Mësimi 6 • Urdhërimi i tetë, nëntë, e i dhjetë	27
<hr/> Perëndia thotë - Krishti është Përgjigja	
Mësimi 7 • Hyjnia e Tij	31
Mësimi 8 • Jeta e Tij	35
Mësimi 9 • Vdekja e Tij	39
Mësimi 10 • Ringjallja e Tij	43
<hr/> Perëndia thotë - Cili është reagimi juaj?	
Mësimi 11 • A je i shpëtuar?	47
Mësimi 12 • A je duke u rritur?	51
Shtojca 1: Vizualet	55
Shtojca 2: Materiale për shpërndarje	87

Hyrja



**Të ndihmosh
adoleshentët që të
zbulojnë se çfarë thotë
Perëndia**

Manuali “Perëndia thotë” është prodhuar nga Bashkësia e Ungjillëzimit të Fëmijëve të Evropës për shërbesën e Nxitjes për të Rinjtë. Është pjesë e një cikli pesë vjeçar dhe siguron material të mjaftueshëm për 12-24 sesione.

Mësimet janë shkruar për 11-15 vjeçarë por mund të përshtaten edhe për një grup me moshë më të madhe. Mund të plotësojnë nevojat e adoleshentëve të shpëtuar e të pashpëtuar. Disa mësimet japin një paraqitje të qartë të ungjillit, ndërsa disa të tjera i ndihmojnë të krishterët e rinj në ecjen e tyre me Perëndinë, por disa prej tyre janë një kombinim i të dyjave.

**Të synosh
mendjet, zemrat
e duart**

Objektiva të qarta jepen në fillim të çdo mësimi, duke u fokusuar në tre aspekte:

Njohje 🧠 emocione ❤️ veprime 🖐️.

Është mjaft e rëndësishme që jo vetëm të mësojmë doktrinën, por edhe ta zbatojmë me besnikëri. Adoleshentët duhet të inkurajohen që t’i zbatojnë në praktikë mësimet në jetën e tyre të përditshme.

Një objektiv shtesë **PA** jepet për të treguar sesi të pashpëtuarit duhet t’i përgjigjen mësimet.

**Duke përdorur
një sërë
metodash**

Shënime për mësuesit janë vënë në shkrim të pjerrët gjatë tekstit të mësimet. Ata sigurojnë një sërë metodash lehtësuese për përfshirjen e adoleshentëve: studime specifike, luajtje roli, skeçe, intervista, grupe pune etj.

Disa metoda kanë nevojë për shumë kohë. Rekomandohet që mësimi të ndahet në dy pjesë, në mënyrë që të ketë një përdorim të plotë të metodave.

NDARJA E MËSIMIT

Kjo ndarje shënon vendin ku ndahet mësimi. Nëse mësuesi duhet të mbulojë të gjithë mësimin njëherësh, do t’i duhet të zgjedhë idetë që janë më të dobishme për grupin dhe ta lerë pjesën tjetër.

**Përgatitni vizuale
dhe materiale për t’u
shpërndarë**

Vizualet dhe materialet për t’u shpërndarë jepen për të gjitha mësimet. Atyre u vihen numra dhe mbli-dhen në fund të manualit. Teksti i mësimet tregon se ku duhen përdorur. Ju lutem vini re se ato mbrohen me të drejtat e autorit dhe mund të përdoren vetëm nga zotëruesi i të drejtave.

Nëse vizualet do të përdoren në një grup të vogël, ata mund të zmadhohen në letër ose karton. Në një grup të madh, është mirë të fotokopjohen ose të përdoren në video projektor.

Mësuesi mund të përdorë dosjet Power Point, në CD.

Disa vizuale nuk duhet të zbulohen përnjëherësh. Mësuesi mund të vendosë mbulesa dhe t'i heqë pak nga pak ndërsa jep mësimin. Kjo mund të ndihmojë në ruajtjen e vëmendjes. "Vizuali përmbledhës" duhet të përdoret për të përmbledhur mësimet e mëparshme dhe për të shpjeguar vazhdimësinë. Përsëri është më mirë të zbulohet pak nga pak.



Materialet për shpërndarje duhet të fotokopjohen dhe t'u ndahen adoleshentëve. Ata përfshijnë disa ide krijuese: fjalëkryqe, tabela, pyetje etj. Adoloshentët mund t'i plotësojnë ato gjatë programit ose më vonë

në shtëpi. Do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimet dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.

**Të shtosh
ngjyra me CD-në**

CD-ja përmban:





Të gjitha vizualet në bardhë e zi dhe me ngjyra në Adobe Acrobat PDF dhe Power Point.

Të gjitha Materialet për shpërndarje në bardhë e zi dhe me ngjyra në PDF.

Shpresojmë që ky material të jetë një bekim për shumë mësues dhe adoleshentë. ●

Pse të studiojmë Biblën?

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë se pse Bibla është një libër i veçantë, sepse Perëndia e ka frymëzuar!
-  Të kuptojnë se Bibla mund të ndryshojë shumë jetët e tyre dhe t'i formojë ata që të jenë personat që Perëndia dëshiron të jenë.
-  Të lexojnë Biblën sistematikisht dhe të kërkojnë udhëzimet e Perëndisë për jetën e tyre të krishterë.
-  Të gjejnë në Bibël udhën e shpëtimit.

Hyrja: Skeç në një dyqan librash

U kërkoni që më parë adoleshentëve të përgatisin një skeç të vogël në dy pjesë, një për hyrjen e mësimi dhe një për përfundimin. Jepuni një roman, biografi, një libër udhëtimi dhe lloje të ndryshme Biblash.

- Suzi hyn në një dyqan librash: “Unë dua një libër të veçantë, diçka tërheqëse!”
- Shitësi: “Ja një roman fantastik. Sapo ta fillosh, nuk do ta lëshosh dot nga dora.
- Suzi: “Jo dua një tregim të vërtetë që të më nxisë”.
- Shitësi: “E kuptoj, ja një biografi e mrekullueshme, shumë frymëzuese”.
- Suzi: “Jo, dua diçka që të më ndihmojë që të gjej rrugën time në jetë”.
- Shitësi: “Ah, ju keni nevojë për një libër udhëtimi! Merre këtë dhe do të jesh gati për udhëtimin për pushimet e ardhshme!”

Suzi zhgënjehet. Por ne do ta takojmë atë përsëri në fund të mësimi. Çfarë libri do

t'i rekomandonit asaj? A është Bibla libri i veçantë që i duhet asaj? Pse? Në grupin tonë ne studiojmë Biblën. Ky libër është në qendër të gjithçkaje që bëjmë së bashku. Le të shohim se pse ky libër është i ndryshëm nga çdo libër tjetër dhe pse e studiojmë atë.

Bibla është Fjala e Perëndisë



(Vizuali 1 – Tregoni gazetën dhe përmendni titujt e lajmeve ndërsa mbuloni pikat e ardhshme).

1. Frymëzimi

Bibla është shkruar nga njerëzit, por ata

u zgjodhën dhe u udhëhoqën nga Perëndia. Fryma e Shenjtë i udhëhoqi ata në mënyrë që fjalët që ata shkruan të ishin saktësisht ato që Perëndia donte. Shikoni 2 Pjetrit 1:21. Bibla është e frymëzuar nga Perëndia (2 Timoteut 3:16). Është Fjala e Perëndisë!

2. Uniteti

Si rezultat i frymëzimit, Bibla ka një unitet të mrekullueshëm. 66 librat e Biblës janë shkruar nga mbi 40 persona të ndryshëm (barinj, peshkatarë, mbretër, etj.) të cilët kanë jetuar në kohë të ndryshme të historisë. Nga koha e shkrimit të librit të parë deri tek i fundit, bëhen rreth 1600 vjet. Por, për arsye se shkruesit ishin të frymëzuar, ata nuk ishin në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe kanë dhënë një mësim plot harmoni.

3. Saktësia

Fjala e Perëndisë është e saktë. Kjo është konfirmuar gjatë viteve me anë të zbulimeve të ndryshme. Shembull: Lluca 3:1 flet për Lizanin si tetrark i Abilenit.

Për shumë vite studiuesit mendonin se Lluca e kishte gabim, pasi mendohej se Lizani ishte sundimtari i Kalçisit, rreth 50 vjet më përpara sesa e përshkruan Lluca. Por, është gjetur një mbishkrim arkeologjik, në të cilin thuhet se Lizani ka qenë tetrarku në Abilen, në afërsi të Damaskut, në kohën kur e ka thënë Lluca. Tani rezulton se ka pasur dy persona me emrin Lizani.

Saktësia e Biblës mund të shihet edhe në përmbushjen e profecive të Dhjatës së Vjetër. Është veçanërisht mahnitëse ndërsa shqyrtojmë profecitë mbi Zotin Jezus.

Metoda: Grupe pune mbi profecinë

I ndani adoleshentët në grupe me tre apo katër persona. Jepini secilit nga një kopje të Psalmi 22:7-21 dhe Mateut 27:35-46. U kërkoni atyre që të gjejnë përputhjen midis profecisë së Dhjatës së Vjetër dhe shkrimit mbi kryqëzimin e Krishtit në Dhjatën e Re. Sigurohuni që të keni kohë të mjaftueshme për të përdorur këtë metodë. Mund të mos e bëni nëse keni ndër mend që ta jepni tërë mësimin njëherësh.

4. Ruajtja

Gjatë historisë shumë njerëz janë përpjekur ta zhdukin Biblën, por nuk ia kanë dale kurrë mbanë. Fjala e Perëndisë është e përjetshme Isaia 40:8. Ne dimë gjithashtu se ajo është përcjellë besnikërisht, përmes brezave. Në dimrin e 1946-1947, një bari bëri një zbulim të madh pranë Detit të Kuq. Ai gjeti disa enë plot pergamena, të cilat përmbanin kopje të vjetra të Dhjatës së Vjetër. Ndërsa këto tekste krahasoheshin me versionet më të fundit të Biblës, u gjet se ishin mjaft të ngjashme. Ky

ishte një konfirmim i madh se Bibla që ne kemi është e besueshme.

Pra, pse ta studiojmë Biblën? Përgjigjja është e qartë, sepse është Fjala e Perëndisë! Çfarë privilegj është të jesh në gjendje që në çdo kohë të hapësh Biblën dhe të zbulosh atë që na ka thënë Perëndia. Nëse do të merrnit një letër nga një person shumë i famshëm, ju do të ngazëlloheshit për këtë. Aq më shumë duhet të ngazëllohem që kemi mundësi të lexojmë Biblën, Fjalën e Perëndisë!

NDARJA E MËSIMIT

Bibla mund të ndryshojë jetën tuaj



(Shfaqni vizualin 2 pak nga pak ndërsa kaloni përmes pjesës së dytë të mësimi).

Bibla mund të sjellë një ndryshim të vërtetë në jetën tuaj. Ndërsa studioni Biblën, ju do të shihni se është:

1. E fuqishme

Metoda: Ushtrimi me shpate dhe pyetje

U kërkoni adoleshentëve që të “zhveshin shpatat” (të ngrenë Biblën). Jepni një referencë biblike, si për shembull “Romakëve 1:16”. Le ta përsërisin. Pastaj urdhëroni “Sulm!”, që ata të konkurrojnë për të gjetur vargun. Adolehenti i parë që e gjen, ngrihet në këmbë. Jepuni disa çaste të tjerëve që ta gjejnë dhe pastaj kërkoni fituesit që ta lexojë vargun me zë të lartë. Disa pyetje do ta ndihmojnë grupin që të analizojnë vargun. Kujt i referohet fjala “ungjill”? Çfarë fuqie ka ungjilli? Kush mund të shpëtohen? (Ju mund të përdorni të njëjtën metodë ndërsa merreni me vargjet kryesore, në pjesën tjetër të mësimi).

Bibla ju tregon se keni mëkatuar dhe jeni privuar nga standardet e Perëndisë (Romakëve 3:23), por na tregon gjithashtu se Perëndia ka siguruar një rrugëdalje për faljen, nëpërmjet Jezus Krishtit (Romakëve 5:8).

Ungjilli është i fuqishëm – duke u kthyer prej mëkatit dhe duke besuar në Krishtin, ju mund të shpëtoheni. Ndërsa studioni Fjalën e Perëndisë, Perëndia Fryma e Shenjtë mund t'ju flasë përmes saj dhe t'ju tregojë nevojën që keni për shpëtim. Nëse Perëndia ju flet përmes Fjalës së Tij, binduni Atij.

2. E dobishme

Për ata prej nesh që janë të krishterë, studimi i Biblës është me përfitim sepse do të mësojmë gjëra që do të jenë të dobishme për ne. (*Ushtrimi me shpatë për 2 Timoteut 3:16*). Si mund të jetë me përfitim për ne Shkrimi i frymëzuar? Gjeni katër fjalë kryesore.

- Doktrinë (mësim) tregon atë që është e drejtë.
- Bindje (qortim) tregon atë që nuk është e drejtë.
- Ndreqje tregon se si duhet rregulluar.
- Trajnim ose edukim me drejtësi mëson se si të ecësh si duhet.

Fjala e Perëndisë na ndihmon që të mësojmë më shumë mbi atë që besojmë. Ajo mund të na tregojë sfera të jetës në të cilat gabojmë. Mund të na ndihmojë që t'i ndreqim ato dhe të ecim mirë.

3. Personale

Në çdo marrëdhënie, ne mësojmë më shumë për njerëzit ndërsa dëgjojmë atë që ata na thonë. Kur e lëmë Perëndinë që të na flasë përmes Fjalës së Tij, ne e njohim Atë më mirë, ndërsa zbulojmë gjëra për Perëndinë që nuk i dinim më parë. Ndërsa i afrohem Perëndisë, duke lexuar dhe duke iu nënshtruar Fjalës së

Tij, Ai afrohet tek ne dhe marrëdhënia jonë personale me Të forcohet (Jakobi 4:8).

Perëndia mund ta përdorë Fjalën e Tij për të na folur personalisht. Ndërsa lexojmë, mund të zbulojmë një të vërtetë që mund të na ndihmojë që të merremi me një situatë të veçantë me të cilën po përballemi. Perëndia i njeh të gjitha nevojat tona, e kështu është i aftë të na flasë personalisht dhe të na udhëheqë përmes Fjalës së Tij (*Ushtrimi me shpatë për Psalmin 119:105*). Çfarë bën Fjala, sipas këtij vargu? A e ndriçon Perëndia tërë shtegun e jetës sonë, apo na udhëheq hap pas hapi? Si e përforcon kjo marrëdhënien tonë me Të?

4. Praktike

Ndërsa studioni në shkollë ju mësoni shumë gjëra që ju duhen për provim, por që nuk sjellin asnjë ndryshim për llojin e personit që jeni. Fjala e Perëndisë nuk është e tillë! Ajo është praktike, ndikuese në jetët tona të përditshme. (*Ushtrimi me shpatë për Jakobi 1:22*). Çfarë paralajmërimi gjejmë në këtë varg? A mund të mendoni për sfera në të cilat e shohim se e kemi të vështirë për ta zbatuar Fjalën e Perëndisë në praktikë?

Kur zbulojmë diçka në Fjalën e Perëndisë, ne duhet të përpiqemi ta vëmë në praktikë. A besoni se Perëndia dëshiron që ju t'iu bindeni prindërve tuaj? Atëherë bëjeni këtë! Ky udhëzim vjen nga një Perëndi që ju do dhe e di se çfarë është më e mira për ju. A po ju thotë Perëndia që ta ndani mesazhin e Jezusit me shokët tuaj? Ka shumë rëndësi që të bëjmë atë që Ai thotë!

5. E frytshme

Studimi i Biblës dhe bindja ndaj asaj që ajo thotë do të rezultojë e frytshme, duke na bërë ata lloj njerëzish që Perëndia dëshiron që të jemi. (*Ushtrimi me shpatë për Markun 4:20*). Me çfarë krahasohet fjala në këtë varg? Nëse

merrni farën, çfarë duhet të ndodhë? Për çfarë lloj frytësh flet ky varg?

Perëndia kërkon që të krishterët të rriten dhe Ai na e ka treguar se çfarë “fryti” kërkon të shohë në jetët tona (Galatasve 5:22). Të krishterë të rinj, a po prodhon jeta juaj “fryt”? Kjo do të ndodhë vetëm nëse jeni të gatshëm të shpenzoni kohë duke studiuar Fjalën e Perëndisë.

Metoda: Materiale për shpërndarje



Fotokopjoni materialin 1 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë atë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Ai do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.

Përfundim: Pjesa e dytë e skeçit

- Suzi: “Jo, jo nuk dua as libër udhëtimi e as libër biografik apo roman, por kam frikë se as vetë nuk e di se për çfarë po kërkoj?”
- Një klient tjetër në dyqan: “Më fal por ju dëgjova rastësisht. Unë vetë lexoj një libër që më bën mirë dhe më ndihmon për të gjetur drejtimin tim në jetë. A e keni lexuar ndonjëherë Biblën?”
- Suzi duket e interesuar: “Duhet të them se unë nuk e kam lexuar asnjëherë Biblën megjithëse kam dëgjuar të flitet për të”.
- Shitësi: “Eja këtu. Ne kemi disa lloje Biblash...dhe disa oferta të veçanta!”

A nuk është e mrekullueshme të dimë se e kemi Fjalën e Perëndisë të disponueshme në çdo kohë! Çfarë roli luan Fjala e Perëndisë në jetën tuaj? A e keni zbuluar udhën e shpëtimit që tregon ajo dhe e keni vendosur besimin te Jezus Krishti? Nëse po, sigurohuni që për çdo ditë të keni kohë për të studiuar Fjalën e çmuar të Perëndisë. Vetëm atëherë mund të shpresoni që të rriteni e të bëheni ashtu si do Perëndia. ●

PËRGJIGJET E MATERIALIT 1

Gjëgjzë simbolesh: kthyer; bindeni; frymëzoi; unitet; privilegji; Jezus; profecive; ruajtur; Fjala; besuar; Zotit; dyzetë; detit; ndryshojë; saktë.





Plotëso vendet boshe 1: Fjala, frymëzoi, dyzetë, unitet, profecive, saktë, detit, ruajtur.

Ndajini veç: fuqishme, praktike, e dobishme, personale, produktive.

Plotësoni vendet boshe 2: Privilegji, kthyer, besuar, Zotit, Jezus, bindeni, ndryshojë, personin.

Si të studiosh Biblën

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë se Bibla duhet të interpretohet me kujdes.
-  Të kuptojnë se Fryma e Shenjtë e aftëson të krishterët që të kapë të vërtetat e Biblës.
-  Të njihen me disa mjete të rëndësishme studimore dhe t'i përdorin ato në kohën e qetë të përditshme.
-  Të pranojnë Perëndinë në jetët e tyre. Vetëm atëherë ata do të përjetojnë ndriçimin e Frymës së Shenjtë dhe do të përfitojnë plotësisht nga Bibla.

Hyrja: Çani një arrë

U kërkoni tre vullnetarëve që të dalin përpara. Secili të përpiqet të çajë një arrë. I pari duhet ta bëjë këtë me një kaçavidë, i dyti me një thikë të pa mprehur dhe i treti me një thyerëse arrash. A nuk e bën më mirë punën thyerësja e arrave? Nuk ka gjë më irrituese sesa të mos kesh veglën e duhur të punës? Kjo është e vërtetë edhe kur studiojmë Biblën.

Në mësimin e fundit thamë se Bibla është Fjala e Perëndisë dhe mund të ndryshojë jetët tona. A ju kujtohen pesë fjalët që u përdorën për të përshkruar Biblën? (Le t'i përmbledhin adoleshentët). Ne kemi shumë arsye për të studiuar Biblën, por si e bëjmë këtë? Ne na duhet metoda e duhur dhe mjetet e duhura. Ja çfarë mund të bëni. (Shfaqni vizualet 3 dhe 4 gradualisht).

1. Lutu

Së pari duhet të luteni, duke i kërkuar ndihmë Perëndisë. Kujtoni gjithnjë se Bibla nuk është



një libër i zakonshëm – është Fjala e Perëndisë. Nëse nuk kuptoni një libër në shkollë, mund të mendoni me vete “Sa mirë do të ishte të njihja autorin e këtij libri, ai do të ma shpjegonte”. Gjëja e mrekullueshme kur studioni Fjalën e Perëndisë është se nëse jeni të krishterë, Autori i saj është me ju.

Perëndia Fryma e Shenjtë, që i ka frymëzuar fjalët e shkrimit do t'ju ndihmojnë që ta kuptoni atë (Gjoni 15:26 dhe 16:13). Dhënia e të kuptuarit të Shkrimit është një rol jetik i Frymës së Shenjtë në jetën e të krishterit (1 Korintasve 2:10-12). Ju mund të mbështeteni tek ndihma e Perëndisë. Jini të hapur ndaj asaj që Perëndia ka për të thënë. Lejojeni Perëndinë që t'ju mësojë ndërsa studioni. Edhe nëse pasazhi është i njohur, jini gjithnjë gati që të mësoni diçka të re prej tij.

2. Zgjidh




Zgjidhni një pasazh ose libër për ta studiuar dhe punoni me të sistematikisht. Nëse nuk e keni bërë këtë më parë, ju sugjeroj të filloni me Ungjillin e Llukës. Më vonë mund të ndiqni një plan vjetor dhe të përdorni shënimet e kohës së qetë. (I tregoni grupit një plan dhe shënime që janë të përshtatshme për 11-15 vjeçarët).

Metoda: Të ndarit e përvojave

Ju mund të shkoni tek disa pjesëtarë të grupit para studimit dhe t'i pyesni nëse duan të ndajnë


me të tjerët se çfarë libri nga Bibla kanë lexuar së fundi dhe çfarë u ka pëlqyer më shumë. Ky mund të jetë një inkurajim i madh për adoleshentët që nuk kanë ende një kohë të qetë.



3. Lexo

Mos u përpigni të lexoni shumë përnjëherësh. Është më mirë të studioni disa vargje me kujdes sesa të lexoni me ngut një pasazh të gjatë.

Shqyrtojeni pasazhin në kontekstin e vet. Me fjalë të tjera, zbuloni se çfarë vjen para e pas. Mos i merrni vargjet ose pjesë të vargjeve veç e veç, sepse mund të përdoren për të pohuar diçka shumë të ndryshme nga kuptimi i vërtetë. Për shembull, sipas Psalmi 14:1 “nuk ka Perëndi” Por kur shohim tërë vargun, ne shohim që këto janë fjalët e të marrit. Merreni gjithnjë Fjalën e Perëndisë në kontekstin e duhur.



4. Analizoje

Shikojeni mirë se çfarë thotë pasazhi. Ja disa mjete të veçanta që mund t’ju ndihmojnë në analizimin që do të bëni. (Kjo pjesë është shumë e detajuar. Nëse mendoni se adoleshentët nuk janë gati për t’i zbuluar të gjitha këto mjete, i lini disa jashtë dhe merruni me to një herë tjetër).

Ndajini vargjet në pjesë të vogla

– sidomos kur ndesheni me një të gjatë ose të ndërlikuar. Për ta bërë këtë, shikoni nëse përsëritet e njëjta fjalë apo frazë, ose kërkoni për lidhëza si “dhe” “por” etj,

Gjoni 1:1 është një shembull i mirë. “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë dhe Fjala ishte Perëndi”. Analizojeni çdo pjesë veç

e veç. Gjoni po flet për Jezusin që është “Fjala” dhe mëson tre të vërteta të rëndësishme rreth Tij.

Mos u huto nga fjalë të zakonshme!

Çfarëdo lënde të jeni duke studiuar – biologji, matematikë, kompjuter, etj. – ju duhet të mësoni fjalë me kuptim të veçantë. Në Bibël ju do të ndesheni me fjalë të vështira të tilla si “shfajësim” dhe “shenjtërim”. Nëse keni një fjalor biblik (tregojuni adoleshentëve një shembull) ju mund të gjeni kuptimin ose mund t’i kërkoni ndihmë një të krishteri më të rritur.

Kërkoni për gjuhë figurative.

Për shembull, tek Gjoni 6:35 Jezusi tha se ishte “buka e jetës”. Kur ndeshemi me gjuhë figurative ne duhet të pyesim veten se çfarë donte të thoshte autori në të vërtetë.



5. Pyet

Bëni disa pyetje ndërsa studioni.

+ Çfarë mëson pasazhi mbi Perëndinë? Mund të mësojë mbi Perëndinë Atin ose Jezusin Birin ose Frymën e Shenjtë. Bëni një listë të gjithçkaje që mund të gjeni.



+ Çfarë mëson pasazhi mbi njeriun? Ju mund të lexoni

diçka mbi një mëkat (mosbindje ndaj Perëndisë) ose mund të gjeni një shembull për të ndjekur.

+ A ka pasazhe të tjera nga Bibla që mund të më ndihmojnë për ta kuptuar këtë? Disa Bibla kanë referenca paralele në rreshtat anësorë të cilat mund t’i shikoni.

Ndërsa i bëni pyetje të tilla vetes, kjo do t’ju ndihmojë për të kapur kuptimin e pasazhit

dhe do t'ju përgatitë për ta zbatuar pasazhin në praktikë në jetën tuaj.

Përdorni libra studimi për t'ju ndihmuar. Ju mund të gjeni një komentare të mirë mbi librin Biblik që jeni duke lexuar. (Tregojini adoleshentëve një shembull). Këto burime do t'ju ndihmojnë të kuptoni atë që Bibla po thotë, por kini kujdes që të mos lejoni që libra të tjerë të zënë vendin e Biblës.



6. Zbato

Më në fund ju duhet të mendoni për atë që Perëndia dëshiron që ju të bëni. Në mësimin e mëparshëm ne folëm për rëndësinë që ka zbatimi në praktikë i asaj që lexojmë në Shkrim. Jini gati që t'i bindeni çfarëdo gjëje që ju thotë Perëndia përmes Fjalës së Tij. Ju nuk mund të prisni që Perëndia t'ju mësojë gjëra të reja nëse nuk po bëni atë që Ai ju ka treguar tashmë.

Nëse keni ndër mend që ta jepni mësimin në dy pjesë, ndaloni këtu. Fillojeni takimin e ardhshëm me një përsëritje të shkurtër. Pastaj përdorni metodën e mëposhtme për t'u dhënë mundësi adoleshentëve të provojnë disa mjete studimore.

NDARJA E MËSIMIT


Metoda: Grup studimi



Ndajini të rinjtë në grupe të vogla për të studiuar një pasazh nga Bibla. Jepjani materialin 2 të gjithë pjesëmarrësve. Caktoni nga një drejtues të aftë në çdo grup. Drejtuesi

duhet të marrë, që më parë, përgjigjet e materialit (ju mund t'i fotokopjoni përgjigjet që tregohen në të djathtë) dhe të jetë i përgatitur mirë. Ai ose ajo do të udhëheqin adoleshentët, do t'i ndihmojë ata që të gërmojnë nëpër pasazh dhe t'i bëjnë ata të plotësojnë fletën e punës. Ju mund të vendosni se me çfarë pasazhi do të punojnë grupet—Lluka 5:1-11 për fillestarë ose Gjoni 10:7-15 për adoleshentë me përvojë.

Metoda: Kërkim fjale



Fotokopjoni materialin 4 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë atë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.



Përfundimi

Ndërsa përpiqemi të studiojmë Biblën në shtëpi, ndonjëherë ne mund të ndihemi të shkurajuar. (Shfaqni vizualin 5). Duket një detyrë shumë e vështirë për njeriun e vogël në këtë vizual. Por vini re se drita shkëlqen mbi të dhe e bën më të madhe hijen e tij. Kjo e ilustron faktin se me dritën e Perëndisë, ne do të mund të përballemi me sfidën. Nëse jeni fëmijë i Perëndisë, kujtoni se Fryma e Tij e Shenjtë vepron në ju dhe do t'ju aftësojë që të kuptoni fjalën e tij.

Mos u mundoni të çani një kokërr arre me


kaçavidë apo thikë. Përdorni një thyerëse arrash. Me ndihmën e Perëndisë, përdorni metodat e sugjeruara në këtë mësim. Provojini këto mjete studimore në ditët e ardhshme. Në Psalmin 119:103-104, Psalmisti thotë sa e ëmbël është Fjala në gojën e tij, sa shumë ai e do atë dhe sa shumë ndikon ajo në jetën e tij. Nëse jeni një besimtar, këto vargje duhet të pasqyrojnë edhe qëndrimin tuaj. A e doni Fjalën dhe a do ta studioni atë? ●



PËRGJIGJET E MATERIALIT 3

Plotësoni vendet

boshe: Lutu, Fryma e Shenjtë, Zgjidh, sistematikisht, lexo, kontekst, analizo, ndaji, ndërlikuara, fjalët, fjalor, figurative, pyet, Perëndisë, njeriut, pasazhe, zbato, çdo gjë.



PËRGJIGJET E MATERIALIT 2

Përgjigjet për Lluca 5:1-11





- **Konteksti i pasazhit:** Përpara: Jezusi po predikon në Galile. Më pas: Pastron një lebroz, fal dhe shëron një të paralizuar.
- **Fjalë të vështira ose gjuha figurative:** "Do të peshkoni njerëz" – do t'u predikoni ungjillin njerëzve dhe do t'i fitoni për Krishtin.
- **Çfarë mëson pasazhi mbi Perëndinë?** Jezusi mësoi Fjalën e Perëndisë (1). Ai është Mjeshtri (5), Ai ka pushtet mbi natyrën (4-6). Ai është i shenjtë; Ai është Zoti (8).
- **Çfarë mëson pasazhi mbi njeriun?** Ai duhet të dëgjojë Fjalën e Perëndisë (1). Ai duhet të bëjë çfarëdo që Zoti i thotë, edhe kur nuk e kupton (5). Ai është mëkatar dhe ka nevojë për Zotin (8). Ai duhet të jetë një peshkatar njerëzish (10). Ai duhet të ndjekë Jezusin siç bënë dishepujt (11).
- **A ka pasazhe të tjera Biblike që mund të më ndihmojnë ta kuptoj këtë?** Mateu 4:18-20, Marku 1:16-20 – të tjera shkrime mbi thirrjen e dishepujve për t'u bërë peshkatarë njerëzish. Gjoni 21:1-14-Jezusi bëri një mrekulli të ngjashme pas ringjalljes së Tij dhe dishepujt e njohën Atë.
- **Perëndia do që unë të:** le ta plotësojnë adoleshentët këtë pjesë.

Përgjigje për Gjoni 10:7-15

- **Konteksti i pasazhit:** Përpara: Jezusi i kthen shikimin një të verbëri dhe mëson mbi të parit e vërtetë. Më pas: Ai jep më shumë mësimë mbi bariun dhe judejtë duan ta godasin me gurë.
- **Fjalë të vështira ose gjuha figurative:** "Unë jam dera" – Jezusi thotë se është udha e shpëtimit; "unë jam bariu i mirë" – Jezusi kujdeset për ata që i besojnë atij; "Vjedhës", "ujk" – ilustrojnë Satanin që përpiqet të shkatërrojë jetë.
- **Çfarë mëson pasazhi mbi Perëndinë?** Jezusi është udha e shpëtimit (7,9). Ai erdhi që ne të kemi jetë me bollëk (10). Ai i mbron dhe kujdeset për ndjekësit e tij, Ai i njeh ata personalisht (13-15).
- **Çfarë mëson pasazhi mbi njeriun?** Personi që i beson Krishtit është i shpëtuar dhe ka jetë me bollëk (9-10). Ne duhet të jemi të vëmendshëm ndaj Satanit që dëshiron të shkatërrojë jetë (10, 12-13). Besimtarët mund të kenë një marrëdhënie personale me Jezusin (14).
- **A ka pasazhe të tjera biblike që mund të më ndihmojnë për ta kuptuar këtë?** Psalmi 23-flet për kujdesin e bariut për delet e tij. Mateu 18:12-14; Lluca 15:3-7-shëmbëlltira e deles së humbur.
- **Perëndia do që unë të:** Le ta plotësojnë adoleshentët këtë pjesë.

Urdhërimi i parë e i dytë

Objektivat: Ne duam që adoleshentët të:

-  Kuptojnë që Perëndia duhet të ketë vendin e parë në jetët e tyre.
-  Të kuptojnë se shokët, sportet, paratë etj. mund të jenë idhuj të rrezikshëm.
-  Të sigurohen se i kanë përparësitë e tyre në rregull dhe që asgjë të mos pengojë marrëdhënien e tyre me Perëndinë.
-  Të pendohen dhe t'i japin Perëndisë vendin e parë në jetën e tyre.

Hyrja: Eksploroni vizualin



Shfaqni vizualin 6 në fillim të këtij mësimi dhe bëni disa pyetje për t'i ndihmuar adoleshentët që të rindërtojnë bazën historike në të cilën u dhanë Dhjetë Urdhërimet.

- Kush është personazhi biblik që paraqitet në këtë vizual?
- Ku është duke shkuar ai?
- Çfarë ka ai në duart e tij?
- Pse janë këto pllaka shumë të rëndësishme?
- Kur ka ndodhur kjo situatë?

Dhjetë Urdhërimet - Eksodi 20:1-17

Populli i veçantë i Perëndisë, bijtë e Izraelit ishin çliruar nga vite skllavërie në vendin e Egjiptit. Tani ata po ecnin përmes shkretëtirës drejt vendit që u kishte premtuar Perëndia, një vend ku do të vendoseshin dhe do të

bëheshin një komb më vete. Në këtë moment kritik të historisë, Perëndia zbuloi ligjet me anë të të cilave populli i tij duhet të jetojë. Këto ligje njihen sot si Dhjetë Urdhërimet.

Shumë vite më vonë, Zoti Jezus Krisht u pyet se cilat prej ligjeve të Perëndisë ishin më të rëndësishme. Ai u përgjigj duke përmbledhur Dhjetë Urdhërimet – që duhet të duam Perëndinë dhe të afërmin tonë (Mateu 22:37-39). Kjo përmbledhje i ndan urdhërimet në dy pjesë – detyrën tonë ndaj Perëndisë dhe atë ndaj njerëzve.

Le të lexojmë Eksodi 20:1-17. Ndërsa lexojmë, përpikuni të numëroni se sa urdhërimet kanë të bëjnë me detyrën tonë ndaj njerëzve. (Mund t'ju duhet të thoni se vargjet 4-6 shihen si një urdhërim i vetëm).

Gjatë javëve të ardhshme ne do të studiojmë Dhjetë Urdhërimet. Duke e bërë këtë, ne do të zbulojmë se ata janë po aq aktuale sot, siç kanë qenë edhe kur janë dhënë rreth 3500 vite më parë. Perëndia na thotë ende sot: "Këto janë standardet e mia".

Urdhërimi i parë

"Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje" (Eksodi 20:3).

Egjipti, vendi që izraelitët sapo kishin lënë, ishte një vend ku adhuroheshin shumë perëndi. Tani Perëndia po ia bënte të qartë popullit të tij se ata duhet të adhuronin vetëm Atë.

(Shfaqni vizualin 7). Ai kërkoi vendin e parë



në jetët e tyre. Askush dhe asgjë tjetër nuk duhet të zinte vendin e tij. Urdhërimi i parë ua bënte të qartë izraelitëve se gjëja më e rëndësishme në jetë ishte marrëdhënia e tyre me Perëndinë. Sot ka njerëz që adhurojnë idhujt në vend që t'i japin Perëndisë vendin e duhur. Unë i kërkoja gjashtë prej jush që të luani rolin e disave prej tyre.

Metoda: Zoti dhe Zonja (Pjesa e parë).

Gjashtë adoleshentë (me të cilët keni folur më parë) do të vijnë. Secili ka një emër të ndryshëm të shkruar mbi një distinktiv: Zoti Stadiumi, Zonja Shoqëria, Zoti Uebisiti, Zonja Moda, Zoti Regu dhe Zonja Kuleta. Ju do t'i intervistoni ata duke përdorur pyetjet e mëposhtme.

- 1. Cili është pasioni juaj i madh në jetë?** (Për zotin Stadium "Futbolli" kurse për zonjën Shoqëria "Miqte", etj.).
- 2. Cila është gjëja e parë që bën çdo mëngjes?** (Zoti Stadium "Po vras mendjen se çfarë ndeshje futbolli do të ketë sot në TV? Zonja Shoqëria "Unë lexova mesazhet në celularin tim"; etj.).
- 3. Çfarë mund të jetë një zhgënjim i madh për ty?** (Zoti Stadium "Kur humbet skuadra ime e preferuar"; Zonja Shoqëria "Kur nuk kam asnjë të dashur" etj.).
- 4. Çfarë dëshiron më shumë të blesh?** (Zoti Stadium "Një biletë për finalen e kampionatit"; Zonja Shoqëria "Një kompjuter të ri me anë të të cilit të mund të dërgoj email etj.).
- 5. Cili është synimi yt kryesor?** (Zoti Stadium "Të bëhem një futbollist; Zonja Shoqëria "Të kem shumë shoqe dhe të jetoj me to" etj.).

Nëse mikrofoni do t'ju drejtohej juve, si do t'i përgjigjeshit ju këtyre pyetjeve? Cila është gjëja kryesore në jetën tuaj? Futbolli, shokët, etj. nuk janë të këqija në vetvete, por duhet të zënë vendin e duhur. Ju duhet të kuptoni

se ajo që zë vendin e parë ndikon zgjedhjet tuaja, synimet dhe përdorimin e parave etj. Ju duhet të siguroheni që Perëndia të ketë vendin e parë fare në jetën tuaj. Perëndia ju krijoi që ta doni dhe të jetoni për Të.

Ndoshta ju nuk e keni vënë Atë akoma në këtë pozitë kyçe. Ndoshta ju keni frikë se çfarë do të thonë shokët, ose po të bëheni të krishterë mund t'i humbisni plotësisht ata. Ndoshta ju e dini se që të bëheni të krishterë do të thotë që të hiqni dorë nga disa gjëra që bëni apo vende të preferuara. Ndoshta ju nuk jeni të gatshëm që t'i jepni Perëndisë vendin kryesor në jetën tuaj sepse ju duket se ka shumë gjëra nga të cilat duhet hequr dorë.

Por dëgjoni atë që Zoti Jezus ka thënë te Marku 8:36. Çfarë përfitimi do të keni ju me këto nëse humbisni shpirtin? Ne kemi shkëlur urdhërimin e parë. Ne nuk e duam Perëndinë dhe nuk jetojmë për Të ashtu si duhet. Ne nuk i japim vendin kryesor. Ne të gjithë kemi mëkatuar dhe jemi privuar nga lavdia e Perëndisë (Romakëve 3:23). Por Perëndia e ka bërë të mundur që ne të falemi duke dërguar Zotin Jezus për të vdekur në Kalvar (Hebrenjve 9:22). Duke u kthyer prej mëkatit tuaj dhe duke besuar te Jezusi, ju mund të bëheni të drejtë me Perëndinë. Atëherë, ju jo vetëm do të keni marrëdhënien e drejtë me Të dhe do të jeni gati për përjetësinë, por edhe do të zbuloni gëzim dhe qëllim të vërtetë në jetën e tashme (Gjoni 10:10). Çfarëdo gjëje që ju pengon, nuk ia vlen. Flakini tutje ato gjëra dhe jepjani Perëndisë vendi kryesor në jetën tuaj.

Metoda: Zoti dhe Zonja (Pjesa e Dytë)

Kthehuni tek pesë pyetjet e përdorura gjatë intervistës. Pyetini të rinjtë se si duhet t'u përgjigjet një i krishterë këtyre pyetjeve. Le të bëjnë ata disa sugjerime para se të lexoni si më poshtë:

- 1. "Unë e dua Zotin Jezus mbi gjithçka. Ka dhe shumë gjëra të tjera që më pëlqejnë por Jezusi është i pari".**

2. "Unë lexoj Biblën dhe lutem çdo mëngjes. Nuk është gjithnjë e lehtë por është mënyra më e mirë për të nisur ditën".
3. "Unë nuk dua që të jem i pabindur ndaj Zotit. Kur ndodh e di se mund t'i kërkoj Perëndisë falje dhe Ai e jep atë".
4. "Unë dua të blej një biçikletë të re që të shkoj në shkollë me të dhe në grupin e të rinjve me shokët e mi".
5. "Unë nuk kam shumë synime në jetë por kryesori është t'i shërbej Zotit dhe të jem gjithnjë e më i ngjashëm me Të!"

Nëse jeni të krishterë, kërkojini Zotit që t'ju ndihmojë t'i bindeni vazhdimisht këtij urdhërimi të parë. Tashmë ju e keni marrë vendimin për të jetuar për Perëndinë, por a i është dorëzuar jeta juaj Atij krejtësisht? Ndonjëherë ne të krishterët mund të lejojmë që gjërat që zotërojmë, preferencat, paratë apo shokët, të hyjnë midis nesh dhe Perëndisë. Gjëra që nuk janë mëkatore në vetvete, bëhen mëkatore nëse u japim, në jetën tonë, vendin që i takon me të drejtë Perëndisë. Ne duhet të kujtojmë që marrëdhënia jonë me Perëndinë është gjëja më e rëndësishme në jetët tona. Nuk duhet të lejohet asgjë që të zërë vendin e Tij.

NDARJA E MËSIMIT

Urdhërimi i dytë

"Nuk do të bësh shëmbëlltë të gdhendur"



(Eksodi 20:4).

Nëvendineri, izraelitët do të rrethoheshin nga kombet që bënin skulptura të perëndive të tyre prej druri apo guri, por ata e kishin të ndaluar ta bënin këtë. Perëndia ua ndaloi atyre që të përdornin skulptura për ta adhuruar Atë. Kjo ndodh edhe sot. (Tregoni vizualin 8).

Pse ua ndaloi Perëndia këtë? Sepse Ai është i gjithëpushtetshmi, i përjetshmi e i gjithëfuqishmi Perëndi. Asnjë skulpturë sado e madhe, nuk do të mund ta jepte ndonjëherë pamjen e asaj që Ai është në të vërtetë. Në vend të kësaj do të jepte thjesht një pamje të rreme. Krijimi ose adhurimi i një skulpture e çnderon Perëndinë.

Që ta adhurojmë Perëndinë ashtu si duhet, ne duhet të kemi një pamje të vërtetë të asaj që Ai është në të vërtetë. Mjerisht shumë njerëz kanë një kuptim të pasaktë të karakterit të Perëndisë. Çfarë kanë ata në mendje? Figurën e një gjyshi plak? Babagjyshin e Krishtlindjes? Për shumë njerëz, Perëndia është një figurë e dobët, pa fuqi. Për të tjerët Ai është thjeshtë një Perëndi i dashur që nuk na ndëshkon, çfarëdo që të bëjmë. Ne të gjithë rrezikojmë që të kemi një pamje të paplotë të Perëndisë, duke krijuar një imazh të Perëndisë në mendjen tonë. Kështu ne nuk e adhurojmë Perëndinë ashtu si duhet.

Perëndia dëshiron që të adhurohet në të vërtetë (Gjoni 4:23). Prandaj është kaq e rëndësishme që të studiojmë Biblën për të zbuluar më shumë mbi karakterin e Tij, që ta njohim më mirë. Perëndia e zbulon veten e Tij nëpërmjet Fjalës së Tij.

Metoda: Grupe pune mbi "Perëndinë që adhurojmë"

Ndajini adoleshentët në grupe me tre ose katër dhe shpërndajini vargjet e mëposhtme. Ata do të shikojnë vargjet dhe do të shkruajnë me fjalët e tyre atë që zbulojnë rreth Perëndisë. Nëse e jepni mësimin në dy pjesë, ju mund të zgjeroni listën e vargjeve.

Perëndia që adhurojmë...

1. _____ (Psalmi 103:19)
2. _____ (Jeremia 32:17)
3. _____ (Romakëve 1:18)
4. _____ (Romakëve 6:23b)

Përgjigjet: Ai është në kontroll të të gjitha gjërave; Ai mund të bëjë çdo gjë; është plot me zemërim kundër mëkatit; Ai siguron një rrugëdalje për faljen përmes Jezus Krishtit.

Kur grupet të kenë përfunduar, le të ndajnë atë që kanë zbuluar. Kjo metodë mund të çojë edhe në një kohë adhurimi, gjatë së cilës adoleshentët mund të luten sipas këtyre vargjeve.

Metoda: Fjalëkryq



Fotokopjoni materialin shpërndarës 4 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë atë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.


Përfundimi

Perëndia ua dha këto urdhërime jo vetëm Moisiut dhe popullit të Izraelit. Ai gjithashtu na i ka dhënë edhe neve. Urdhërimi i parë dhe i dytë na nxit ne. Ata vendosin një standard të lartë për marrëdhënien tonë me Perëndinë. Atij duhet t'i jepet vendi kryesor në jetët tona dhe ne duhet ta nderojmë atë përmes adhurimit tonë.

Ne duhet të përballemi me të vërtetën: ne nuk e duam Perëndinë ashtu si duhet. Ju e unë kemi shkelur ligjet e Perëndisë. Por ju gjithashtu e dini se Perëndia ka siguruar një rrugëdalje që ju të faleni përmes Jezus Krishtit. Ju nuk mund të jetoni kurrë sipas standardeve të Tij me forcat tuaja por, duke u kthyer prej mëkatit tuaj dhe duke besuar tek Jezusi. Mos vazhdoni të ecni sipas vullnetit tuaj. Ejani sot tek Zot Jezus. ●







PËRGJIGJET E MATERIALIT 4



Urdhërimi i tretë dhe i katërt

Mësimi 4

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë se emri i Perëndisë duhet të respektohet dhe që e diela të jetë një ditë pushimi dhe adhurimi.
-  Të kuptojnë se këto dy urdhërime janë të shpërfillura në shoqërinë e sotme – ata duhet të kenë kujdes që të mos ecin me turmën!
-  Të ruajnë gjuhën e tyre me kujdes dhe ta përdorin si duhet kohën e tyre ditët e diela.
-  Të pranojnë paaftësinë e tyre për t'iu bindur Ligjit të Perëndisë dhe të pendohen.

Hyrja: Si të kënaqësh

Ta zëmë se ju doni të bëni diçka të veçantë për të kënaqur babain tuaj. Çfarë do të bënit? Ja disa sugjerime. Më thoni se cila është e përshtatshme. (Ju mund ta përshtatni këtë hyrje sipas situatës së familjeve të adoleshentëve të grupit tuaj. Ata mund të mendojnë se si të kënaqin nënën apo dajën (xhaxhain) tuaj).

- ✦ I jepni një buqetë me lule!
- ✦ I lani makinën!
- ✦ Porositni një pica për të!
- ✦ I blini një gazetë!
- ✦ Bëni me të një xhiro me biçikletë!
- ✦ I thoni se e doni atë!
- ✦ Ndonjë sugjerim tjetër?

Në këtë mësim ne duam të mendojmë se si të kënaqim Perëndinë. Në takimin tonë të fundit ne filluam të merreshim me pjesën e parë të Dhjetë Urdhërimeve. Ne pamë që duhet t'i

japim Perëndisë vendin e parë në jetët tona dhe se duhet ta adhurojmë atë ashtu si duhet. Dy urdhërimet vijuese na mësojnë se si mund ta kënaqim atë duke përdorur gjuhën dhe kohën tonë ashtu si duhet.

Urdhërimi i tretë

“Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot” (Eksodi 20:7).

Në kohën e Dhjatës së Vjetër dhe asaj të Re, judejtë kishin një respekt të jashtëzakonshëm për emrin e Perëndisë. Skribët, puna e të cilëve ishte të kopjonin me dorë Shkrimet, merrnin një “penë” të re sa herë që shkruanin emrin e Perëndisë, i tillë ishte respekti që ata kishin për të. Trajtimi jo serioz i emrit të Perëndisë shihej si një shkelje e rëndë.



Sa shumë kanë ndryshuar gjërat në botën tonë sot! (Shfaqni vizualin 9).

Sot emri i Jezus Krishtit është një fjalë e zakonshme betimi. Është e pamundur të ndjekësh një program në televizor pa

dëgjuar emrin e Perëndisë të përdorur kot. Edhe fëmijët e të rinjtë e shkelin vazhdimisht urdhërimin e tretë ndërsa “përmendin emrin e Perëndisë kot”.

Ruhuni gjithnjë që të mos jeni fajtorë për përdorim të emrit të Perëndisë kot. Nëse gjendeni në një situatë në shkollë në të cilën shokët e klasës e përmendin vazhdimisht emrin e Perëndisë kot, është e lehtë që edhe

ju të bëni të njëjtën gjë. Kini kujdes se çfarë thoni. Mbani mend se Perëndia e bën shumë të qartë se do ta dënojë mëkatin e atyre që e përmendin kot emrin e Tij (Eksodi 20:7b).

Metoda: Gishtat e mëdhenj lart

U paraqisni një situatë të vështirë adoleshentëve: “Danieli është i krishterë. Ai po bisedon me një grup shokësh të shkollës dhe njëri prej tyre bën be dhe përdor emrin e Zotit. Çfarë këshille mund t’i japim Danielit për mënyrën se si të veprojnë?”

Lexoni sugjerimet e mëposhtme një nga një dhe u kërkon adoleshentëve që të përdorin gishtin e madh. Nëse u duket këshillë e mirë, të ngrenë gishtin e madh lart. Nëse u duket e keqe, ta ulin. Mund ta mbajnë atë edhe në një pozicion të mesëm.



Ndërsa përdorni këtë metodë, bëni disa komente vetë, jepni udhëzime dhe theksoni se sa e rëndësishme është të mbash një qëndrim të qartë për Zotin sado e vështirë të jetë (sugjerimet 4 dhe 8).

1. “Mos hyr në telashe por thjesht shpërfille atë!”
2. “Prit se mos e bën për herë të dytë!”
3. “Lutu që shoku yt të kuptojë se çfarë është gabim!”
4. “Ti duhet të thuash diçka për të nderuar Zotin dhe për të ndihmuar shokun tënd!”
5. “Pse nuk i shkruan një letër shokut tënd!”
6. “Prit derisa të jesh vetëm me të dhe t’ia shpjegosh!”
7. “Flit me autoritet dhe referoju Dhjetë Urdhërimeve!”
8. “Tregoji me butësi se emri i Perëndisë nuk duhet përdorur në atë mënyrë”.

Secili prej nesh mund të përballet me një situatë të tillë. Nëse jeni të krishterë, si do të reagoni? A do ta shpërfillni atë që është thënë,

ndoshta duke bërë sikur nuk e keni dëgjuar? Apo do të kesh kurajon për të folur, duke ua bërë të qartë se emri i Zotit është i çmuar për ju dhe nuk duhet përdorur në një mënyrë të tillë. Një fjalë e qetë nga një i krishterë mund t’i bëjë njerëzit që të mendojnë për atë që po thonë. Mos kini turp të qëndroni për emrin e Zotit.

Shumë të krishterë nuk do ta përdornin kurrë emrin e Perëndisë si një fjalë betimi por keni menduar ndonjëherë se ka dhe një mënyrë tjetër se si ju mund ta përmendni kot emrin e tij? Si i “krishterë” që jeni, ju keni marrë emrin e Zotit Jezus. Ju shpallni se jeni dikush që i përket Atij. A përputhet jeta juaj me këtë që ju shpallni se jeni? (2 Timoteut 2:19)? Ne duhet të kemi gjithnjë parasysh se sjellja e popullit të Perëndisë reflekton emrin e Perëndisë së tyre. A e shohin të tjerët se po jetoni në një mënyrë që e kënaq Perëndinë? Nëse jo, ju mund të jeni fajtorë të përmendjes kot të emrit të Zotit. Kujtoni paralajmërimin e Perëndisë – çdo njeri i cili e përmend kot emrin e Perëndisë është fajtor para Tij.

NDARJA E MËSIMIT

Urdhërimi i katërt

“Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar” (Eksodi 20:8).

Perëndia e krijoi universin në gjashtë ditë dhe ditën e shtatë pushoi. Në këtë urdhërim, Perëndia na kujton përsëri për këtë fakt dhe na urdhëron që ta mbajmë të “shenjtë” ditën e Shabatit. Fjala “i shenjtë” do të thotë “i ndryshëm” ose i “ndarë veç”. Dita e veçantë e Perëndisë duhet të jetë ndryshe nga ditët e tjera të javës.

Në Dhjetën e Re ne zbulojmë se pas ringjalljes së Zotit Jezus ditën e parë të javës, të krishterët filluan ta mbajnë të shenjtë ditën e parë në vend të ditës së shtatë. Kjo ditë e veçantë u

bë e njohur si “Dita e Zotit” (Zbulesa 1:10). Megjithëse për ne si të krishterë dita aktuale ka ndryshuar nga e shtuna në të diel, parimi mbetet i njëjtë – ajo ditë e javës duhet të jetë e “shenjtë” ose është e “ndryshme” nga ditët e tjera. Po si duhet ta respektojmë të dielën si ditë e ndryshme nga ditët e tjera? (Shfaqni



vizualin 10).

Ajo duhet të jetë:

Një ditë pushimi

Shikoni Marku 2:27. Pse e ka krijuar Perëndia ditën e Shabatit? Ai e bëri këtë për ne, për të

mirën tonë. Ai e di se si funksionojnë trupat tanë (Psalmi 103:14). Është provuar se 6 ditë punë dhe një ditë pushim është ideale për trupin e njeriut.

A është dita e diel një ditë pushimi për ju? Që të mund të pushoni të dielën, ju duhet t'i programoni më mirë aktivitetet tuaja gjatë javës – si për shembull të bëni detyrat e shtëpisë ditët e tjera që të pushoni në ditën e Zotit. Kjo është një mënyrë për të mbajtur të “shenjtë” ose të “ndryshme” të dielën.

Një ditë adhurimi

Duke patur një ditë të lirë nga presionet e punës ose studimit ne kemi mundësi për të adhuruar Perëndinë. Shikoni Hebrenjve 10:25 – çfarë nuk duhet të lëmë pas dore? Mbledhjen tonë në bashkësi. Çdo të diel shkoni në kishë. Duke e ruajtur të lirë të dielën nga gjëra të tjera, na jep kohë për studim Biblik ose për të lexuar libra të mirë të krishterë. Është e rëndësishme që të kemi kohë për të menduar mbi gjithçka që Zoti ka bërë për ne dhe ta lavdërojmë Atë për mirësinë që ka treguar ndaj nesh.

A është e diela një ditë në të cilën ju adhuroni Perëndinë? Apo e keni lejuar që të bëhet si çdo ditë tjetër, aq e zënë me gjërat e tjera sa i kushtoni shumë pak kohë Perëndisë? Mbani mend se kur Perëndia tha se duhet ta respektojmë ditën e Shabatit si të shenjtë, Ai nuk po na jepte thjesht një sugjerim – Ai po na jepte një urdhërim.

Metoda: Studim specifik mbi Erik Lidelin



Ndajini adoleshentët në grupe me katër ose pesë persona. U jepni materialin shpërndarës 5 secilit prej grupeve dhe le të lexojnë studimin dhe të diskutoni pyetjet. (Një mundësi tjetër do të ishte shfaqja e fragmenteve nga filmi

Qerret e zjarrra (Chariots of Fire).

Përfundimi

Urdhërimi i tretë dhe i katërt na mësojnë se dashuria jonë për Perëndinë do të duket nga mënyra se si e respektojmë emrin e Tij dhe ditën e Tij. Si përputhet jeta juaj. A është i kënaqur Perëndia me reagimin tuaj ndaj këtyre urdhërimeve?

Metoda: Kuic

Ideja 1: Ju duhet një top i madh prej letre dhe një kosh mbeturinash. Ndajini adoleshentët në dy skuadra dhe u bëni pyetje secilës prej skuadrave në mënyrë të alternuar. U jepni 100 pikë për një përgjigje të saktë. Pastaj ai që i përgjigjet pyetjes fiton tre mundësi për të marrë më shumë pikë. Mbajeni koshin para vetes. Nga një largësi prej afro 3 metrash, adoleshenti gjuan topin, duke fituar 10 pikë nëse topi bie në kosh. Pastaj mbajeni koshin sipër kokës për një tentativë tjetër që vlen 20 pikë. Në fund mbajeni koshin nga

prapa dhe përkuluni pak përpara për gjuajtjen fundit, që vlen 30 pikë.




Ideja 2: Ju duhen 2 pjatëza si dhe pipa dhe kokrra bizele. U bëni pyetje me radhë skuadrave duke u dhënë nga 50 pikë për një përgjigje të saktë. Pastaj ai që i përgjigjet pyetjes ka 30 sekonda për t'i çuar bizelet nga një pjatëz në tjetrën duke përdorur një pipë. Jepni nga një pikë shtesë për secilën bizele të transferuar me sukses.


Pyetje:


1. Në cilin kapitull të Eksodit janë Dhjetë Urdhërimet? (Kapitulli 20).
2. Si duhet të reagojnë të krishterët kur dëgjojnë emrin e Perëndisë duke u përmendur kot (T'i sfidojnë ata që e përdorin kot emrin e Tij).
3. Përveç betimeve, si mund ta përdorim ndryshe emrin e Perëndisë kot? (Kur shpallim se jemi të krishterë por jetojmë në një mënyrë që e çnderon Perëndinë).
4. Çfarë shembulli na ka dhënë Perëndia në lidhje me përdorimin e ditës së shabatit? (Ai pushoi pas gjashtë ditë krijimi).
5. Çfarë do të thotë "i shenjtë"? (i ndryshëm ose i ndarë mënjane).
6. Pse të krishterët e respektojnë ditën e parë të javës si të veçantë në vend të ditës së shtatë? (Është dita kur u ringjall Zoti).
7. Si mund ta programoni javën që të pushoni në ditën e Zotit? (Duke i bërë detyrat e shkollës, etj., ditët e tjera).
8. Përveç se të pushojmë, çfarë tjetër duhet të bëjmë ditën e Zotit? (Ta adhurojmë Atë). ●


Urdhërimi i pestë, i gjashtë, i shtatë

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

 Të kuptojnë se çfarë qëndrimi dëshiron Perëndia që të kenë ndaj prindërve, bashkëmoshatarëve dhe atyre të gjinisë tjetër.

 Të kuptojnë se nuk duhet vetëm të sillen mirë, por të ruajnë mendjen nga zemërimi, hakmarrja, mendimet lakmuese, etj.

 Të kenë një qëndrim të dashur dhe respektues dhe të ruajnë mendjet dhe të kundërshtojnë çdo mendim të keq.

 Të kuptojnë se nuk mund t'u binden urdhërimeve të Perëndisë dhe duhet t'i kërkojnë Zotit Jezus që t'i shpëtojë ata dhe të shenjtërojë mendjet e qëndrimet e tyre.

Hyrja: Zgjidhni dhjetë njerëz

Ju keni marrëdhënie me shumë njerëz: prindër, vëllezër, motra, pjesëtarë të tjerë të familjes, mësues të shkollës, mësues muzike, trajnerë sporti, shokë, fqinjë, pjesëtarë të kishës, shoferë autobusi, etj. Çfarë liste!

(Vendoseni tekstin e mëposhtëm mbi një poster ose letër transparente. I lexoni dhjetë pikat një nga një dhe u kërkonit adoleshentëve që të mendojnë vetë se kë do të zgjedhin).

Ndër këta njerëz, kush do të jetë..

1. Ai që ju njeh më mirë?
2. Ai që do të donit të zhdukej?
3. Ai, ndaj të cilit e keni të vështirë t'i bindeni?
4. Ai me të cilin keni lidhje të ngushtë?
5. Ai që ta harron gjithnjë ditëlindjen?
6. Ai me të cilin nuk do të shkonit kurrë për pushime?

7. Ai tek i cili do të shkonit për ndihmë?
8. Ai me të cilin grindeni gati për ditë?
9. Ai të cilin do ta ndiqnit kudo?
10. Ai, dashuria e të cilit është e padiskutueshme?

Nëse jemi të krishterë, ne duhet ta duam Perëndinë – katër urdhërimet e para. Por dashuria jonë për Perëndinë duhet të ndikojë në mënyrën se si i trajtojmë të tjerët. Ndërsa studiojmë urdhërimin e pestë, të gjashtë dhe të shtatë, le t'i kërkojmë Zotit që të na nxisë për qëndrimin tonë ndaj të tjerëve.

Urdhërimi i pestë

“Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde” (Eksodi 20:12).

“Të nderosh” do të thotë të kesh një vlerësim të lartë, të tregosh respekt, të trajtosh dikë si të çmuar, siç bën ky djalë i vogël në këtë vizual (Paraqitni vizualin 11).



Prindërit tuaj janë të çmuar për ju. Mendoni për gjithçka që ata bëjnë dhe kanë bërë për ju. Ata punojnë shumë për të siguruar gjëra të tilla si ushqim, rroba dhe shtëpi. Ata madje ju japin gjëra që nuk nevojiten por që i pëlqeni. Mendoni për gjënë e fundit të veçantë apo dhuratën e fundit të ditëlindjes që ju dhanë. Ata ju paralajmërojnë për shumë rreziqe dhe ju udhëheqin kur duhet të merrni vendime. Ata janë një dhuratë e mrekullueshme për ju nga Perëndia!

Ju mund të keni tendencën për t'i harruar të gjitha këto kur keni vështirësi me prindërit tuaj. Ndonjëherë ata ju ndalojnë që të bëni atë që u lejohet të tjerëve. Ata nuk e kuptojnë gjithnjë atë që është e rëndësishme për ju. Mendimi i tyre në lidhje me stilin e flokëve, rrobat apo muzikën është shpesh i ndryshëm. Disa vendime që ata marrin mund të duken të padrejta. Ankesat tuaja mund të jenë të përligjura. Është e vërtetë që prindërit nuk janë të përsosur, por ata bëjnë më të mirën që mundën për ju. Mos e harroni atë që ata bëjnë për ju. Ata janë të çmuar.

Perëndia do që ju t'i nderoni ata. Ju mund ta bëni këtë duke iu bindur atyre, duke qenë të dashur me ta e duke iu folur me respekt. Mendoni se si flisni për prindërit tuaj me të tjerët. Kur nuk pajtoheni me prindërit, flitni me ta me respekt. Ju mund ta shpjegoni se si ndjeheni. Dëgjoni me kujdes pikëpamjen e tyre. Pastaj ju duhet ta pranoni çfarëdo vendimi që ata marrin. Ndoshta ju keni prindër që, ose nuk janë prindërit tuaj natyrorë ose jetojnë me ju vetëm për një farë kohe – Perëndia do që t'i nderoni edhe ata.

Për shembull prindërit tuaj ju thonë që të ktheheni më herët në shtëpi sesa shokët tuaj. Që t'i nderoni ata, si duhet të reagoni? Ju mund të flisni me ta për këtë, por pranojeni vendimin e tyre. Mos u ankoni për ta me shokët tuaj. Kthehuni në kohën që ata thonë. Nëse, për shkak të rrethanave të papritura ju do të vonoheni, i telefononi për t'ua shpjeguar situatën. Njerëzit që nderojnë prindërit e tyre kënaqin Perëndinë dhe marrin bekimet e premtuara prej Tij (Efesianëve 6:1-3).

Metoda: Dramë

Që t'i ndihmoni adoleshentët të zbatojnë urdhërimin e pestë, luani një dramë.

“Përfytyroni sikur jeni ftuar në një festë të veçantë. Shumë prej shokëve tuaj do të jenë atje dhe do të qëndrojnë tërë natën. Ju nuk doni ta

humbni këtë rast! Ju e dini se prindërit nuk kanë për ta pëlqyer idenë që ju të flini atje, por ju vendosni të shkoni dhe të flisni me ta për këtë”.

Gjeni tre vullnetarë, (mund të përfshini edhe një drejtues) që janë të gatshëm për të marrë pjesë në këtë dramë. Dy prej tyre do të luajnë rolin e babait dhe nënës (të cilët nuk janë të bindur që fëmija të rrijë natën atje por janë të hapur për të folur për këtë). Vullnetari i tretë do të përpigjet të zbatojë urdhërimin e pestë në këtë situatë. Kjo do të ndihmojë grupin të mendojë mbi mënyra të përshtatshme për të komunikuar me prindërit dhe do t'i përgatitë ata për të pranuar me respekt çfarëdo vendimi që merret ose çfarëdo udhëzimi jepet.

NDARJA E MËSIMIT

Duke e dhënë mësimin në dy pjesë do të keni mundësi për të shpenzuar më shumë kohë me dramën dhe të përfitonit sa më shumë nga kjo metodë. Mund të jetë interesante që ta luani situatën jo vetëm një herë por dy ose tre herë dhe me aktorë të ndryshëm. Pas çdo përpjekje, flisni me grupin për atë që mund të përmirësohet. Në takimin vijues do të studioni urdhërimin e gjashtë dhe të shtatë.

Metoda: Diskutim në grup

Ndajini adoleshentët në grupe me nga 5 apo 6 veta, me një drejtues për secilin. Ata do të diskutojnë urdhërimin e gjashtë dhe të shtatë në dritën e mësimëve të Jezusit. U jepni drejtuesve të grupit pyetjet dhe përgjigjet që më parë që të vijnë të përgatitur mirë. U jepni vizualet 12 e 13 e kopje të mjaftueshme të materialit shpërndarës 6. Lejoni rreth 20 minuta për diskutim, e pastaj kini një raport të shkurtër.



Urdhërimi i gjashtë

“Nuk do të vrasësh” (Eksodi 20:13). (Tregoni vizualin 12).



1. Pse shumë njerëz nuk ndihen të shqetësuar nga ky urdhërim?

Sepse mendojnë se nuk mund të vrasin dikë. Ata mendojnë se vetëm terroristët dhe psikopatët mund të vrasin.

2. Lexoni Mateu 5:21-24. Si e ndryshojnë fjalët e Jezusit mënyrën se si e shohim urdhërimin e gjashtë?

Jezusi thotë se fjalët e hidhura dhe plot zemërim janë njësoj me vrasjen – në të dyja rastet shkelim ligjet e Perëndisë. Ai na shtyn të mendojmë mbi motivet tona. Megjithëse mund të mos shkojmë deri aty sa të vrasim, a kemi urrejtje në zemrën tonë për të tjerët? Nëse po, atëherë jemi fajtorë të shkeljes së ligjit të Perëndisë.

3. Shokët tuaj janë zemëruar me një djalë të klasës, sjellja e të cilit i ka shkaktuar telashe tërë klasës. Ata tani duan të hakmerren. Çfarë duhet të bëni?

Evitoheni tundimin për t’u përfshirë në të folur me hidhërim apo në plane hakmarrjeje, ndonëse mund të duket e justifikueshme. Tregojeni me sjelljen dhe qëndrimin tuaj se i shihni gjërat ndryshe. Nëse është e mundur, nxitini ata që të mos kërkojnë hakmarrje. Lutuni për situatën dhe kërkonin ndihmën e Perëndisë që të veproni në një mënyrë që është e kënaqshme për Të.

Urdhërimi i shtatë

“Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore” (Eksodi 20:14). (Paraqitni vizualin 13).



1. Ndoshta ju mendoni se fjala “tradhti bashkëshortore” ka të bëjë vetëm me të rriturit e martuar. Si zbatohen fjalët e Jezusit te Mateu 5:27-28 ndaj këtij urdhërimi për këdo?


Përsëri Jezusi fokusohet mbi mendime e jo thjesht veprime. Mendimet lakmuese dhe kurorëshkelja janë njësoj të neveritshme në sytë e Perëndisë.

2. Jezusi është duke thënë se mendimet lakmuese janë të gabuara. Çfarë mund të bëni që t’i shmangni këto lloj mendimesh?

Kur tundoheni, kërkojini Perëndisë t’ju ndihmojë t’i fokusoni mendimet mbi diçka tjetër. Kini kujdes se çfarë librash, revistash, videosh, filmash, muzike dhe programesh televizive zgjidhni? A jua mbushin mendjen me mendime të këqija? Nëse po, atëherë shmangini. Në vend të kësaj fokusoheni mendjen në gjëra që do t’ju ndihmojnë për të kënaqur Perëndinë (Filipianëve 4:8).

3. Si duhet të përgjigjen të krishterët ndaj idesë së përhapur gjerësisht se seksi jashtë martesës nuk ka asgjë të keqe?

Të krishterët duhet ta kundërshtojnë këtë ide. Fjala e Perëndisë e bën të qartë se vullneti i tij për seksin kufizohet vetëm brenda martesës. Fjala “kurvëri” në greqisht ka të bëjë me marrëdhënien seksuale midis një burri dhe gruaje që nuk janë të martuar (tradhtia bashkëshortore është një lloj kurvërie). Përmendet disa herë në Dhiatën e Re (p.sh. 1 Thesalonikasve 4:3-5) si diçka nga e cila duhet të largohemi.

Metoda: Kuic

Fotokopjoni materialin shpërndarës 7 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.

PËRGJIGJET E MATERIALIT 7

Plotësoni vendet boshe: shkelim, vrasja, prindërit, babai, nuk, i gjashtë, urrejtje, mëkat, eksodi, bindje, nëna, urdhërimet, mendimet, nderojmë, i shtatë, njëzetë, respekt, i pestë, katërmbëdhjetë, tradhti bashkëshortore.

Plotësoni vendet boshe: pendohuni dhe kthehuni.





Përfundimi

A jeni të vendosur që të nderoni prindërit tuaj në ditët në vazhdim? Mendoni për atë që mund t'i bëni atyre për t'i treguar sesa të çmuar janë për ju. A do të kontrolloni gjithashtu mirë mendjen dhe do të refuzoni çdo mendim të keq që mund të keni ndaj të tjerëve?


Ndërsa i shqyrtoni këto urdhërime, ju e kuptoni se vetëm Perëndia mund t'ju aftësojë që t'i bëni këto gjëra. Por nëse e keni rrëfyer mosbindjen tuaj dhe e keni lënë Atë të kontrollojë jetën tuaj, mund të mbështeteni tek Ai. Ndërsa do të takoheni me shumë njerëz në ditët në vazhdim, Zoti do t'ju aftësojë që t'i doni e respektoni ata. ●

Urdhërimi i tetë, nëntë, e i dhjetë

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë nënkuptimin e këtyre tre urdhërimeve për vjedhjen, gënjeshtren dhe lakminë (p.sh. nuk duhet të vjedhim vetëm zotërimi por edhe reputacionin dhe kohën e tjetrit, etj.).
-  Të kuptojnë se vetëm Perëndia mund t'i aftësojë ata që t'i binden këtyre urdhërimeve.
-  Të mësojnë ndershmërinë, sinqeritetin dhe të kënaqurit.
-  Të pendohen dhe t'i besojnë Atij të Vetmit që mund t'i shpëtojë nga mëkati i tyre.

Hyrja: Testi me zar



Bëni zare dhe ua ndani adoleshentëve në fillim të mësimi. Ju mund të fotokopjoni materialin 8 mbi letër të trashë, pritni zarët, i palosni dhe i ngjitni.

A do ta pranoni një test të vogël? Gjatë ditëve në vijim, analizoni jetën tuaj me kujdes. Kur nuk i bindeni njërit prej urdhërimeve të Perëndisë, vëreni zarin diku në dhomën tuaj të gjumit në numrin 1. Kur ndodh për herë të dytë, pastaj kthejeni zarin në numrin 2 e kështu me radhë. Shikoni se në cilën fazë të javës arrini tek nr.6. (Në përfundim do të tregoni se zari mund të kthehet në një kryq).

Ndërsa studiojmë Dhjetë Urdhërimet, ne duam të shqyrtojmë jetët tona, të kuptojmë se çfarë kërkon Perëndia prej nesh, si mund ta duam Atë dhe të tjerët më shumë. Deri tani

kemi studiuar shtatë nga Dhjetë urdhërimet. A mund të bëni një listë të tyre? Tani do të shohim tre urdhërimet e fundit.

Urdhërimi i tetë

“Nuk do të vjedhësh” (Eksodi 20:15).



(Paraqitni vizualin 14). Ky është një nga urdhërimet më të shkurtra të Dhjetë Urdhërimeve. Është shumë i thjeshtë e i drejtpërdrejtë – njerëzit e Perëndisë nuk duhet të vjedhin. Ky urdhërim, qartazi,

na ndalon që ne të vjedhim zotërimi. Ne duhet të jemi të ndershëm me atë që u përket të tjerëve. Është e qartë se është e gabuar marrja e parave nga kuleta e të tjerëve, apo të vjedhim një çokollatë nga dyqani i ëmbëlsirave.

Sigurisht që jo vetëm të krishterët i përmbahet këtij standardi. Edhe njerëzit që nuk kanë kohë për Perëndinë e pranojnë parimin se marrja e asaj që nuk i përket atyre është e gabuar. Por shumë njerëz lejojnë një mënyrë më të stërholluar vjedhjeje. Ka dhe gjëra të tjera që nuk duhet të vidhen, ashtu siç do ta shohim në skeçin e mëposhtëm.

Metoda: Skeç: “Fajtor”

Një skeç mund ta ndihmojë grupin që të kuptojnë nënkuptimin e këtij urdhërimi. Katër persona çohen në gjyq për vjedhje, por ata besojnë se nuk kanë bërë asgjë të keqe! Gjyqtari do t'i ndihmojë që të kuptojnë se në çmënyrë kanë vjedhur nga të

tjerët.

- **Gjykatësi:** – Uluni ju lutem. Çështja e parë. Zonja A, ti akuzohesh se i ke vjedhur fqinjës. A i pranon faktet?
- **Zonja A:** – I nderuar gjykatës, nuk po kuptoj gjë. Unë nuk i kam marrë asgjë fqinjës!
- **Gjykatësi:** Sipas dëshmitarëve, ti ke vjedhur nga reputacioni i saj duke zbuluar diçka nga e kaluara e saj. A i pranon apo jo faktet?
- **Zonja A:** I kam thënë disa shoqeve se çfarë ka bërë ajo, por nuk ka qenë aq sekrete apo jo.
- **Gjykatësi:** Jo ka qenë, e ti je fajtores e duhet të paguash 100 000 lekë. Çështja tjetër.

Personat B, C dhe D do të dalin para trupit gjykses. B i ka vjedhur kohë punëdhënësit duke e lënë shpesh punën herët. C ka vjedhur nga një kompani muzikore duke bërë kopje të një CD-je për shoqet e saj. D i ka vjedhur shtetit duke mos shpallur disa prej të ardhurave për të paguar më pak taksa. Skeçi mund të nxisë disa reagime tek të rinjtë. Flisni me ta për këto mënyra të ndryshme të të vjedhurit.

Kur ne vjedhim, ne nuk mëkatojmë thjesht ndaj të tjerëve por ndaj Perëndisë (Psalmi 51:4). Në fakt është e mundur që ne t'i vjedhim drejtpërdrejt Perëndisë duke mos i dhënë Atij atë që i takon. Fjala e Perëndisë na thotë se një e dhjeta e të ardhurave tona i përket Atij (Malakia 3:8-10). Kjo nuk zbatohet vetëm ndaj atyre që punojnë me kohë të plotë, por edhe ndaj parave tuaja të xhepit ose rrogës së një pune me kohë të pjesshme. A je fajtor për vjedhje ndaj Perëndisë?

Urdhërimi i nëntë

“Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd” (Eksodi 20:16).

Perëndia nuk gënjen kurrë (Titit 1:2). Ai është

plotësisht i besueshëm dhe do që populli i Tij të jenë të tillë. Në mënyrë të qartë e shkelim këtë urdhërim kur themi gjëra jo të vërteta. Ndoshta një detyrë shkolle nuk dorëzohet në kohë dhe thuhet një gënjeshtër si justifikim. Ose ndoshta e kuptojmë se diçka që kemi bërë do të na fusë në telashe dhe kështu e mohojmë që jemi përfshirë.

(Paraqitni vizualin 15).


Çfarë mendoni se po ndodh në këtë vizual?

Duke treguar një gënjeshtër, ne shkelim urdhërimin e nëntë dhe nuk i pëlqejmë

Perëndisë, i Cili dëshiron që ata që besojnë tek Ai të jenë të sinqertë (Fjalët e Urta 12:17).

Megjithatë, Perëndia nuk ndalon vetëm gënjeshttrat flagrante, por edhe tregimet gjysmë të vërteta që japin një përshtypje të rreme, ose kur qëndrojmë në heshtje pasi dëgjojmë dikë që tregon një histori që nuk është e vërtetë. Perëndia kërkon një sinqeritet të plotë në çdo pjesë të jetës sonë (Psalmi 51:6).

Metoda: Iluzion optik



Pritni dy rripa letre në vizualin 16 – “Gënjeshtra të vogla” dhe “Gënjeshtra të mëdha”. Mundohuni që ta pritni rripin “gënjeshtër e vogël” brenda vijës. Iluzioni shkon më mirë pa vijën.

Tregojuni dy rripat adoleshentëve, duke ngritur “Gënjeshttrat e vogla” mbi “ato të mëdha” dhe pyesni se cila është më e vogla? “Gënjeshttrat e vogla” duken më të vogla. Por kur i bashkojmë të dy rripat shohim se ato kanë të njëjtën madhësi!

Ndonjëherë ne përpiqemi të gjejmë justifikime për gënjeshtat që themi. Flasim për “gënjeshtra të vogla” për të cilat themi se nuk kanë rëndësi. Por Perëndia nuk mendon kështu. Fjala e Tij e bën të qartë se Ai e urren pandershmerinë (Fjalët e Urta 6:16-17).

NDARJA E MËSIMIT

Urdhërimi i dhjetë

“Mos lakmo” (Eksodi 20:17).



(Paraqitni vizualin 17). Çfarë mendoni se po ndodh në mendjen e peshkatarit që ndodhet në të djathtë? Të lakmosh do të thotë të kesh zili për diçka që i përket një tjetri. A fokusohet mendja jonë mbi zotërimet e një shoku? Ne ndjejmë një dëshirë për ta pasur apo blerë të njëjtën gjë dhe nuk kënaqemi derisa ta kemi. Kjo është lakmi.

Ky është një urdhërim mjaft nxitës sepse ka të bëjë me mënyrën si mendojmë, e jo thjesht me gjërat që ne bëjmë. Të lakmosh në mendje është një mëkat në vetvete, por edhe të çon lehtë në mëkate të tjera në veprim, si vjedhja.

Ne përballemi me shumë tundime për të lakmuar.

Reklamat na thonë vazhdimisht se ka gjëra që patjetër duhet t'i kemi. Le t'i shqyrtojmë disa prej tyre.

Metoda: Reklamat e gazetave

U kërkoni adoleshentëve të ndahen në grupe me nga tre veta. Jepini çdo grupi nga një gazetë apo revistë. Ata duhet të kërkojnë për reklama dhe të zgjedhin një që i tërheq vëmendjen. Pas dy minutash, ata ia tregojnë tërë grupit dhe identifikojnë dy gjëra.

- Produkti që nxitemi të blejmë.
- “Kurthi” i përdorur për të na shtyrë që ta bëjmë këtë.

A ju shkon në mendje për ndonjë personazh Biblik që ka pasur probleme me këtë? Ashabi lakmoi vreshtin e Nabothit (1 Mbretërve 21) dhe ishte gati të gënjente, vriste dhe vidhte për ta shtënë në dorë. Davidi lakmoi gruan e Uriahut dhe kjo e çoi në kurorëshkelje dhe vrasje (2 Samuel 11). Lakmia nuk ka të bëjë vetëm me zotërimet materiale. Ne mund të lakmojmë marrëdhëniet, pozitën sociale, pamjen, talentet e gjëra të tjera të të tjerëve.

Ne duhet të ruhem nga lakmia. Ajo është një mëkat serioz sepse tregon mosmirënjohje ndaj Perëndisë. Kur ne lakmojmë diçka sikur themi: “Zot, unë nuk jam i kënaqur me atë që më ke dhënë”.

Bibla ju jep...

- Një premtim te Mateu 6:31-33: Ati Qiellor e di se çfarë ju nevojitet dhe do ta sigurojë.
- Një udhëzim te Hebrejve 13:5: ju duhet të jeni të kënaqur me atë që keni.
- Një shembull te Filipianëve 4:11: apostull Pali mësoi të jetë i kënaqur në çfarëdo situatë që ndodhej.

Kujtoni premtimin, binduni mësimet dhe ndiqni shembullin e dhënë nga Pali!

Përfundimi

Tani që ne kemi mbuluar Dhjetë Urdhërimet, a jeni gati për testin e zareve? Sa herë që nuk u bindeni Ligjit të Perëndisë, javën vijuese, kthejeni zarin në numrin pasues. Por kur arrini gjashtën, hapeni zarin dhe do të zbuloni formën e një kryqi! (Shfaqeni këtë).

Ju dhe unë nuk mund të jetojmë një jetë pa mëkat. Nuk mundemi për shkak të natyrës

sonë mëkatore. Kështu siç jemi, nuk mund të qëndrojmë në praninë e shenjtë të Perëndisë (Romakëve 3:23). Por Perëndia na deshi aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij, Zotin Jezus Krisht. Ai nuk mëkatoi. Ai e zbatoi Ligjin përsosmërisht gjatë gjithë jetës së Tij. Kur u ndëshkua në kryq, kjo nuk ndodhi për mëkatet e Tij por për tonat që ne të ishim të falur (1 Pjetër 3:18).

A jeni larguar nga mëkatet tuaja dhe a e kenit pranuar Jezusin si Shpëtimtarin e Zotit tuaj? Ai do t'ju ndihmojë si të krishterë që të respektoni urdhërimet e Tij. Në studimet tona të ardhshme biblike do të flasim më shumë se kush është Jezusi dhe çfarë ka bërë për ne.





Metoda: Kuic alfabeti

Ndajini adoleshentët në dy skuadra. Kur përmendni një shkronjë, personi i parë që ju sjell një objekt që fillon me atë shkronjë (si për shembull M – monedhë; L – laps; O – orë) fiton të drejtën për t'iu përgjigjur pyetjes që fillon me atë shkronjë. Një përgjigje e saktë fiton dhjetë pikë. I përmendni shkronjat të përziera. Nëse nuk gjendet asnjë objekt, bëjua pyetjen të dyja skuadrave dhe lëreni personin e parë që ngrihet t'iu përgjigjet. Nëse është e gabuar, pyetja i kalon skuadrës tjetër.

- Kush ishte personi, emri i të cilit fillon me “A” që lakmoi vreshtin e Nabothit? (**Ashabi**)
- Cila është ajo gjë që fillon me “P”, të cilën nuk duhet ta bëjmë ndaj një idhulli? (**Përkulemi**)
- Cila është ajo gjë që fillon me “L”, diçka që ka të bëjë me zilinë që kemi për diçka që i përket një tjetri? (**Lakmia**).
- Cila fjalë fillon me “D” që vjen para shprehjes “e Zotit” dhe “e Shabatin”? (**Dita**)
- Cili është vendi që fillon me “E” prej nga ishin arratisur izraelitët? (**Egjipti**).
- Cila është fjala që ka të bëjë me vendin që kërkon Perëndia në jetën tonë, që fillon me “P”? (**Pari**).
- Cila është fjala që fillon me “F” që përshkruan tërë shkelësit e urdhërimeve të Perëndisë? (**Fajtor**).
- Cila fjalë që fillon me “N” përshkruan dikë që nuk gënjen? (**Ndershëm**).
- Çfarë ndalohet në urdhërimin e dytë, që fillon me “SH”? (**Shëmbëlltyrë**).
- Kush person, emri i të cilit fillon me “J” i përmbodhi Dhjetë Urdhërimet duke thënë se duhet ta duam Perëndinë dhe të afërmin tonë? (**Jezusi**).
- Çfarë ndalohet në urdhërimin e nëntë (fillon me G)? (**Gënjeshtër**).
- Çfarë ndalohet në urdhërimin e gjashtë, që fillon me “V”? (**Vrasja**).
- Cila është fjala që fillon me “N, që haset në nëntë prej urdhërimeve? (**Nuk**).
- Kush duhet të nderohen gjithnjë (fillon me “P”)?: (**Prindërit**).
- Cila fjalë që fillon me “M” është fjala e parë e urdhërimit të katërt? (**Mbaje mend**).
- Cili urdhërim që fillon me “D” i ndalon idhujt? (**Dytë**).
- Në cilin kapitull të Eksodit që fillon me “Nj” gjenden Dhjetë Urdhërimet? (**Njëzetë**).
- Çfarë duhet të bëjnë njerëzit e Perëndisë në ditën e veçantë (fillon me “A”)?: (**Adhurojnë**).
- Kë person, që fillon me “U” vrau Davidi që t'iu merrte të shoqen? (**Uriahun**).
- Cila është fjala, që fillon me “K” e që ka të bëjë me përmendjen e emrit të Perëndisë? (**Kot**). ●

Hyjnia e Tij

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të zbulojnë provat e shumta të hyjnisë së Jezusit.
-  Të kuptojnë faktin se Vetë Perëndia erdhi në tokë.
-  Të forcohen në besimin e tyre në Krishtin dhe ta lavdërojnë atë.
-  Të vënë besimin e tyre te Ai që mund t'i shpëtojë ata.

Hyrja: një hetim

A keni dashur ndonjëherë të jeni detektivë? Sot ne do të kryejmë një hetim mbi një person. Synimi ynë do të jetë të zbulojmë se cili është identiteti i vërtetë i këtij personi. Në filma ne shohim detektivë që bëjnë hetime të tilla. Si mund të mbledhë një detektiv të dhëna për të përcaktuar identitetin e dikujt? (Le të japin adoleshentët disa ide e pastaj shtoni disa të tjera).

- ✦ Takohuni me këtë person dhe i bëni pyetje.
- ✦ Kontrolloni pasaportën e tij, të dhënat e lindjes, llogaritë bankare etj.
- ✦ Pyesni njerëz që e njohin atë.

Të gjitha informacionet e mbledhura duhet të zbulojnë të vërtetën. Sot hetimi ynë ka të bëjë me Jezusin. Ne duam të zbulojmë se kush ka qenë Ai me të vërtetë.

Le të kujtojmë së pari atë që kemi studiuar gjatë javëve të kaluara. Ne pamë dy subjekte mjaft të rëndësishme—Biblën dhe urdhërimet. Ne zbuluam se Bibla është aktuale për ne sot dhe Dhjetë Urdhërimet na treguan sa larg jemi në lidhje me standardet e Perëndisë. Ne


nuk mund t'i zbatojmë ata me forcat tona. Pra cila është përgjigja ndaj problemit të mëkatit tonë dhe sfidës për të jetuar jetën e krishterë? Perëndia thotë “Zoti Jezus Krisht është përgjigja!” Prandaj do të kemi disa studime mbi Jezusin, sot dhe javët që do të pasojnë.

Ne nuk do të hetojmë mbi ekzistencën e Jezusit. Pranohet gjerësisht fakti që Ai ka jetuar në tokë 2000 vjet më parë. Ka më shumë shkrime mbi Jezusin sesa mbi Jul Çezarin! Por njerëzit nuk bien të gjithë dakord për atë se kush ishte Jezusi në të vërtetë. Këtë duam të hetojmë.

Disa njerëz thonë se Ai ishte thjesht një njeri që pati shumë ndikim me mësimet dhe mënyrën e Tij të jetuarit. Të tjerë thonë se Jezusi ishte më shumë se një njeri, Ai ishte dhe është Perëndia Biri. Të besosh se Jezusi është Perëndi do të thotë të besosh në “Hyjninë” e Tij. Hetimi që do të bëjmë tani është mjaft i rëndësishëm sepse nëse Jezusi nuk ka qenë me të vërtetë Perëndi atëherë ai nuk mund të kishte vdekur për mëkatet tona.

1. Një shpallje mahnitëse

(Paraqitni vizualin 18 pak nga pak gjatë mësimi).




Le të marrim fletoren e shënimeve dhe magnetofonin e të shohim së pari se çfarë ka thënë Vetë Jezusi mbi identitetin e tij. Një ditë ndërsa po u fliste judejve, Jezusi bëri një deklaratë të habitshme. “para se të ishte Abrahami, unë jam” (Gjoni 8:58). Kjo deklaratë përmban dy gjëra të rëndësishme.

- ✦ “UNË JAM”. Që të kuptojmë domethënien e këtyre fjalëve, duhet të lexojmë Eksodi 3:13-14. Perëndia iu zbulua Moisiut përmes një shkurreje që digjej dhe tha: “UNË JAM AI QË JAM”. Pra Jezusi u prezantua në të njëjtën mënyrë si Perëndia. Duke përdorur të njëjtat fjalë, Jezusi shpalli se ishte Perëndi!
- ✦ “Para Abrahamit”. Jezusi shpalli se ekzistonte para Abrahamit. Ai është i përjetshëm. Ai ishte gjithnjë Perëndi, është Perëndi dhe do të jetë gjithnjë Perëndi në të ardhmen. Judejtë që dëgjuan Jezusin e kuptuan atë që Ai shpalli dhe donin ta vrisnin me gurë!

2. Një lindje e mrekullueshme

Dëgjuam atë që Jezusi tha për Veten. Çfarë do të bënte një detektiv i mirë më pas? Ndoshta do të bëj disa kërkime mbi prejardhjen e këtij personi. Një pasazh i mirënjohur tek Mateu 1:18-25 na tregon për dy gjëra të rëndësishme për sa i përket lindjes së Jezusit.



- ✦ Ai u ngjiz nga Fryma e Shenjtë (18-20).
- ✦ Ai lindi nga një virgjëreshë (23-25).


Kjo është një mrekulli e pabesueshme. Fjala e përdorur për ta përshkruar atë është “mishërim” që do të thotë Perëndia në formën e Zotit Jezus u bë një njeri dhe jetoi mes njerëzve.

Ndonjëherë paraqitja që i bëjmë historisë së krishtlindjes e nxjerr Jezusin shumë të dobët dhe sentimental. Ne duhet të kuptojmë se ndonëse Jezusi ishte një foshnjë normale, Ai ishte edhe Perëndia i përjetshëm dhe i gjithëfuqishëm. Është një mister dhe një e vërtetë e mrekullueshme! Mishërimi ishte një demonstrim i fuqisë por edhe i dashurisë së vërtetë për njerëzimin. Perëndia na desh aq

shumë sa që Ai erdhi në botë për të shpëtuar njerëzit nga ndëshkimi që meritojnë për mëkatin e tyre. Emri “Jezus” do të thotë “Shpëtimtar” (Mateu 1:21).

3. Përmbushen profecitë

Një detektiv i mirë kontrollon më shumë dokumente që të sigurohet mirë për atë që ka zbuluar. Le të marrim lentin zmadhuese dhe të kthehemi tek Dhjata e Vjetër. Ajo na tregon shumë për Jezusin.



Metoda: Tabelë

Riprodhoni tabelën e mëposhtme në një dërrasë dhe u kërkoni adoleshentëve që të shohin vargjet dhe të kenë një vullnetar që të dalë e ta plotësojnë.

	Profecitë e Dhjatës së Vjetër	Profecitë e Dhjatës së Re
Vendlindja	Mikea 5:2	Mateu 2:1
Arritja në Jeruzalem	Zakaria 9:9	Gjoni 12:12-15
Kryqëzimi	Isaia 53:12	Mateu 27:38
Identiteti	Isaia 7:14	Gjoni 12:45


Disa prej këtyre profecive mbi Jezusin janë shkruar më shumë se 1000 vjet para se Ai të vinte. Saktësia me të cilën janë përmbushur profecitë na japin një besim të jashtëzakonshëm se Jezusi është Perëndi. Mundësia që këto profeci të përmbushen në një person është jashtëzakonisht e vogël. Kjo është një provë e mrekullueshme që tregon për hyjninë e Jezusit.

NDARJA E MËSIMIT

4. Emrat, atributet dhe veprat

Ne kemi dëgjuar deklaratën e Jezusit, kemi hetuar mbi lindjen e tij dhe kemi shqyrtuar profecitë mbi të. Por një detektiv nuk lë mënjanë asnjë informacion. Këtë herë ne do të ndahemi në grupe për të bërë kërkime të mëtejshme.

Metoda: Grupe pune



Ndajini adoleshentët në grupe me nga katër ose pesë veta dhe u jepni kopje të materialit 9. Do të kenë 10 minuta për të lexuar vargjet dhe për të plotësuar fletët. Pastaj mbliidhni tërë grupin, jepni mundësi për reagime dhe bëni disa komente shtesë.

Emrat e Tij na tregojnë se Ai është Perëndi.

- Jakobi 1:1 – ZOT – na kujton se Ai është hyjnor.
- Titi 2:13 – PERËNDI DHE SHPËTIMTAR – vetëm ai mund të shpëtojë.
- Gjoni 20:31 – BIRI I PERËNDISË – Jezusi është Perëndia i Përjetshëm, Biri.

Atributet e tij na tregojnë se është Perëndi.

- Gjoni 1:1-2 – “Fjala” e PËRJETSHME do të thotë Zoti Jezus.
- Gjoni 2:24-25 – I GJITHËDITUR – i njeh të gjithë njerëzit dhe gjithçka rreth tyre.
- Hebrenjve 4:15 – PA MËKAT – tunduar por kurrë nuk mëkatoi.

Veprat e tij na tregojnë se Ai është Perëndi.

- Gjoni 1:3 – KRIJUES – asgjë nuk u bë pa Të.
- 2 Korintasve 5:10 – GJYKATËS – vetëm Perëndia mund të gjykojë dhe të jetë tërësisht i drejtë.

- Mateu 9:6 – FAL MËKATET – vetëm Perëndia mund të falë mëkatin.

5. Ndjekës besnikë

Ne kemi arritur gati në fund të hetimit tonë mbi Jezusin. Ka dhe një hap të fundit në kërkimin tonë – të dëgjojmë ata që e kanë njohur Jezusin. Ndoshta ju mund të identifikoheni me disa prej tyre.

- Pjetri ishte një nga dishepujt e Jezusit që e dëgjoji Atë, shikoi Atë, jetoi me Të për 24 orë në ditë. Jezusi e pyeti atë dhe dishepujt e tjerë: “Po ju, kush thoni se jam unë?” Dhe Simon Pjetri duke u përgjigjur tha: “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë” (Mateu 16:16). Ai ishte i sigurt se Jezusi ishte Ai që ishte shpallur prej profetëve dhe ishte me të vërtetë Perëndi. A e besoni ju këtë gjithashtu?
- Pali ishte ndër ata që nuk besonte se Jezusi është Perëndi. Por ai e takoi Atë në rrugën për në Damask. Bindjet dhe jeta e tij u shndërrua krejtësisht. Tani ai e dinte se Jezusi ishte Perëndi dhe se erdhi për të vdekur për të (Filipianëve 2:5-8). A e keni bërë të njëjtin zbulim?
- Pasi Jezusi vdiq, Thomai ishte plot me dyshime pavarësisht nga gjithçka që dinte mbi Jezusin. Ndoshta edhe ju ndiheni si ai, por Zoti iu shfaq atij dhe dishepujt e tjerë. Kur Thomai pa shenjat e gozhdëve mbi duart dhe në ijë ai tha: “Zoti dhe Perëndia im!” (Gjoni 20:28).

Përfundimi

Nëse deri tani ju nuk keni besuar se Jezusi është me të vërtetë Perëndi, çfarë mund të thoni kur përballeni me të gjitha këto prova të jashtëzakonshme? Sigurisht do t’ju nxisë të kuptoni se Ai është hyjnor dhe që ju duhet të vini tek Ai për shpëtim. Në fillim, Pjetri, Pali

dhe Thomai nuk besuan por pastaj zbuluan se kush ishte me të vërtetë Jezusi. Jo vetëm kaq, por ata i besuan Atij për shpëtim. Ata zbuluan se Jezusi ishte përgjigjja për të gjitha nevojat e tyre, sepse Ai është Perëndi.





Nëse je i krishterë, ajo që kemi studiuar duhet ta forcojë besimin tënd tek Zoti Jezus dhe duhet të të nxisë ta adhurosh dhe ta lavdërosh Atë. Ti ke një Shpëtimtar që është me të vërtetë Perëndi, prandaj besoji Atij për gjithçka. ●

Jeta e Tij

Mësimi

8

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të konsiderojnë jetën e Jezusit – Ai mësonite me autoritet, lutej në çdo rrethbanë, kujdesej për njerëzit dhe ishte i gatshëm të kalonte përmes shumë vuajtjeve.
-  Të kuptojnë që Jezusi ka dhënë një shembull të përkryer për ata që ta ndjekin, në mënyrë që të kenë sukses në jetë.
-  Të imitojnë Krishtin veçanërisht në mes të jobesimtarëve – duke dëshmuar, duke u lutur dhe duke u kujdesur për ta, pavarësisht nga kundërshtimi.
-  Të kuptojnë se jetët e tyre nuk kanë kuptim dhe t'i kërkojnë Jezusit që t'i shpëtojë ata dhe t'u japë drejtim të qartë.

Hyryja: Ata janë të shquar në histori!


Jepuni adoleshentëve një emër, si p.sh. “Albert Ajnshtajn”. Ata duhet të thonë çfarëdo gjëje që u vjen në mendje mbi këtë person të famshëm, p.sh. “ $E=mc^2$! Shkencëtar i madh! Zbulime të mrekullueshme!” Bëni të njëjtën gjë me disa emra të tjerë – Marko Polo, Pablo Pikaso, Mozart dhe Napoleon.

Vini re se ne i kujtojmë këta njerëz për atë që kanë arritur gjatë jetës së tyre. Ata janë shquar në historinë e botës në mënyra të ndryshme. Por Ai që ka pasur ndikimin më të madh në histori ka qenë Zoti Jezus! Sot ne duam të mendojmë për atë që Ai ka bërë gjatë jetës së Tij.

Deri tani kemi hetuar hyjninë e Jezusit. (Përmendni pesë titujt e mësimin të kaluar). Çfarë kemi zbuluar deri tani duhet të na

mrekullojë. Por le ta çojmë një hap më tej dhe të shqyrtojmë jetën praktike të Krishtit. Çfarë bëri Ai gjatë jetës së Tij në tokë? Për çfarë mbahet mend Ai? Ndoshta shumë gjëra vijnë në mendjen tuaj. Si ishte Ai me të vërtetë? Çfarë mund të mësojmë nga jeta e Tij? Si ndikon shembulli i Tij tek ne sot? Jeta e Zotit Jezus kishte shumë aspekte. Sot, ne do të mendojmë për katër karakteristika të rëndësishme të jetës së Tij.

1. Një jetë mësimi



(Paraqitni pjesën e parë të vizualit 19). Jezusi jepte mësim në shumë raste. Te Marku 1:21–22 nuk na thuhet se çfarë ai tha në sinagogën e Kapernaumit por njerëzit që e dëgjuan Atë u mrekulluan. Ai mësonite me një autoritet të ri, që nuk ishte fituar nga prejardhja e tij prej judeu, por nga fakti që Ai është Perëndi. Ai i tërhiqte turmat kudo, ndërsa ua paraqiste të vërtetat njerëzve me anë shëmbëlltyrash, pyetjesh reflektuese dhe shkrime nga Dhjata e Vjetër.


Jezusi nuk ishte i interesuar vetëm që të jepte të dhëna – Ai donte një reagim ndaj asaj që Ai thoshte. Kujtoni atë që Zakeu vendosi të bënte pasi dëgjoji mësimin e Jezusit (Lluka 19:8-10).

Zoti Jezus e lavdëroi reagimin e Zakeut. Vetë Jezusi ishte në qendër të mësimëve të Tij dhe donte që njerëzit të rilindnin e jo thjesht të dinin fakte. Mësimi i Tij nuk ishte për zbatimje por një shkëmb mbi të cilin të ndërtojmë jetët tona. Ai tregonte nevojën tonë të madhe për Të. Njohja jonë e mësimëve të Tij nuk varet nga arsimimi, aftësitë ose truri ynë por nga të hapurit e zemrës.

A është zemra juaj e hapur ndaj Zotit dhe mësimëve të tij? Nëse i keni besuar Zotit dhe jeni shpëtuar, a mund t'ua shpjegoni mesazhin e Krishtit të tjerëve që kanë nevojë për Të? Jezusi ishte shembulli ynë i përsosur i të dëshmuarit. Ne nuk mund të dëshmojmë kurrë aq mirë sa Ai. Por ne mund të përpiqemi ta shpjegojmë Ungjillin ndaj grupmohës sonë nëpërmjet dëshmisë sonë personale, pyetjeve mbi drejtimin e jetës së personit tjetër dhe nëpërmjet shkrimeve. Ju keni nevojë që mësimin e Jezusit të ndikojë në jetën tuaj dhe atë të shokëve tuaj.

2. Një jetë lutjeje

(Paraqitni pjesën e dytë të vizualit 19). Jeta e Jezusit ishte gjithashtu një jetë lutjeje. Ai është lutur në shumë rrethana të ndryshme.



Metoda: Grupe pune

Ndajini adoleshentët në grupe të vogla me nga tre deri pesë veta dhe u jepni materialin 10.




Ata duhet t'i lidhin referencat Biblike në të djathtë të informacionit në kolonën e dytë.

Ne duhet të lutemi për ndihmë për t'u përballur me tundimet, për të marrë vendime, për të rritur besimin



PËRGJIGJET E MATERIALIT 10



tonë dhe atë të të tjerëve dhe për t'u bërë më të fortë kundër Satanit. Ne duhet të lutemi sidomos kur jemi të zënë dhe nëse nuk jemi shumë të zënë, atëherë duhet të gjejmë rastin për të pasur një kohë më të gjata lutjeje.

Mbi të gjitha ne duhet të lutemi që vullneti i Perëndisë të bëhet. Lluka 18:1 na kujton se duhet të lutemi vazhdimisht dhe të mos heqim dorë.

NDARJA E MËSIMIT

3. Një jetë përkujdesi



(Paraqitni pjesën e parë të vizualit 20).


Jezusi kujdesej seriozisht për njerëzit. Ai shëroi

njerëz (Mateu 8:3), dëboi demonë (Marku 1:26) dhe ringjalli njerëz nga të vdekurit (Gjoni 11:43-44). Ndërsa u bënte të mira njerëzve, shpesh shpjegonte nevojat e shpirtave të tyre. Shërimi fizik shpesh shoqërohej nga falja e mëkateve (Mateu 9:1-8). Në këtë mënyrë të mrekullueshme Krishti tregoi dhembshuri për këdo.

Ai ishte gjithashtu miku i të gjithëve. Ishte miku i të dëbuarve, gjë që i bëri farisenjtë të ankoheshin (Lluka 15:2). Ai hëngri drekë me Zakeun, i cili urrehej në Jeriko. Ai u miqësua me disa prej farisenjve dhe me Jozefin e pasur nga Arimatea. Ai i trajtoi të gjithë njëllor dhe foli për dënim për ata që nuk e ndiqnin Atë, pavarësisht nga prejardhja e tyre (Gjoni 3:18).

Sa keq që njerëzit e refuzojnë ende dashurinë dhe kujdesin e Tij! Ai kujdeset për nevojat dhe problemet tuaja më të mëdha dhe ju mund t'ia sillni Atij të gjitha. Nëse i besoni Atij, a kujdeseni edhe ju për të tjerët? Ju mund të vizitoni një person të moshuar që jeton i vetmuar dhe t'i ofroni ndihmë në çfarëdo mënyre që mundeni. Ndoshta ju mund të ndihmoni dikë që ngacmohet në shkollë ose të shpenzoni kohë me dikë që ka pak shokë. A kujdeseni për të pa shpëtuarit, aq sa t'u flisni për nevojën që kanë për Zotin Jezus?


4. Një jetë vuajtjesh



Jezusi provoi kohë gëzimi dhe trishtimi – Ai ishte një njeri, siç e mësuam në mësimin e mëparshëm. Ai u trishtua shumë nga vajtimi i Maries dhe vdekja e Llazarit

(Gjoni 11:33,35). Por, si Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtar, Ai ka kaluar më shumë vuajtje se çdo njeri. Ai e la shkëlqimin e qiellit për ju e për mua, që të vuante poshtërimin e kësaj bote. (Paraqitni pjesën e dytë të vizualit 20). Ai vuajti mohim nga judejtë. Ata u përpoqën madje ta vrisnin me gurë. Jezusi vajtoi për Jeruzalemin kur ata nuk donin të vinin tek Ai (Lluka 13:34). Ai u mundua në lutje në Malin e Ullinjve (Lluka 22:44). Krishti vuajti edhe më shumë, siç do ta shohim në mësimin e ardhshëm.


A jeni gati të vuani për hir të Tij? Si mund të vijë vuajtja juaj? Ndoshta përmes një talljeje të vogël, veçimi nga të tjerët ose kur ju duhet t'u thoni "jo" disa gjërave të caktuara në të cilat gjeni kënaqësi, por që e dini se janë të gabuara. Ne duhet të jemi të gëzuar sepse në vuajtjet tona, në një mënyrë të mrekullueshme, ne marrim pjesë në vuajtjet e Krishtit. Ç'privilegj!



Metoda: Gjëgjëza e jetës së Jezusit

Siguroni lapsa me ngjyra ose materiale piktore. Bëni kopje të materialit 11 mbi karton dhe u jepni secilit nga një. Kërkojini adoleshentëve që të ndahen në grupe me

nga 4 veta dhe përgatitni një gjëgjëzë (pazëll) që paraqet katër aspekte të ndryshme të jetës së Krishtit. Ideja është që të bashkosh të gjitha copëzat për të formuar një poster të bukur. Çdo grup duhet të mendojë mbi orientimin e çdo copëze të gjëgjëzës para se të fillojë të vizatojë apo pikturojë. Ndonjë grupi mund t'i mungojë frymëzimi. Jini gati t'u jepni disa ide. Për shembull vizatoni katër pjesë të ndryshme të trupit:



mësimi = goja

lutja = gjunjë

kujdesi=duart

vuajtjet=zemra


Të gjitha posterat mund të shfaqen në galerinë e arteve të grupit

Përfundimi

Si përmbledhje, ne mund të themi se jeta e Jezusit ishte një jetë e të dhënit. Zoti Jezus mbahet mend për mënyrën se si e derdhi vazhdimisht jetën e Tij për ata që e rrethojnë. Ai dha nëpërmjet mësimit, lutjes, përkujdesit dhe vuajtjeve.

Për çfarë do të mbahet mend jeta juaj? Jezusi ka dhënë një shembull të përsosur që ju ta ndiqni. A do të ecni në hapat e Tij? A do të dëshmoni? A do të luteni dhe do të kujdeseni për të tjerët? A jeni gati që të vuani për emrin e Tij? Ndiqni shembullin e Tij. Mësoni t'i dorëzoheni Perëndisë dhe të tjerëve. ●

Metoda: Kuic




Fotokopjoni materialin 12 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë atë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.







PËRGJIGJET E MATERIALIT 12

Plotësoni vendet boshe: Perëndi; shpallje; Abrahamit; lindje; Fryma; virgjëreshë; profecitë; vdekjen; atributet; veprat; ndjekës; jetë; mësimi; lutjesh; përkujdesi; vuajtjesh.



Vdekja e Tij

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë që mëkati na bën skllëvër, por vdekja e Jezusit mund të na çlirojë.
-  Të gëzohen me mënyrën e mrekullueshme të shpëtimit të Perëndisë.
-  Të lavdërojnë Perëndinë dhe të ngushëllohen në sigurinë e tyre të shpëtimit.
-  **PA** Të pendohen nga mëkatet e tyre dhe të vendosin besimin e tyre te Jezusi.

Hyrja: Ngjarjet kryesore në histori

I pyesni adoleshentët se cilat kanë qenë orët më të rëndësishme në historinë e botës.

- Hapi i parë i njeriut në hënë?
- Rënia e murit të Berlinit?
- Transplantimi i parë i zemrës?
- Zbulimi i elektricitetit?


Të gjitha këto ngjarje të mëdha kanë pak rëndësi në krahasim me gjashtë orët gjatë të cilave Zoti Jezus duroi mëkatet tona dhe vdiq në kryqin e Kalvarit. Le të lexojmë Marku 15:25-38. Ndërsa do të shohim vdekjen e Krishtit, le të kemi kujdes që te mos e marrim lehtë atë, e cila është ngjarja më e rëndësishme në histori dhe zemra e krishtërit.

Gjatë dy studimeve të fundit ne kemi vendosur themelin e asaj që do të shohim në këtë studim. Ne kemi dashur të shohim nëse Jezus Krishti është me të vërtetë Perëndi dhe pastaj kemi parë jetën e Tij për t'u njohur me natyrën e vërtetë të Perëndisë Bir, ndërsa ishte në tokë.

Pyetja që duhet të marrë përgjigjen është: “Nëse Jezus Krishti është Perëndi dhe jetoi

një jetë të përsosur, atëherë pse i duhej të vdiste?” Përgjigja na vjen lehtë në majë të gjuhës: “Për shkak të mëkatit tonë”. Ai lindi me synimin që të na shpëtojë prej mëkateve tona (Mateu 1:21). Por pse është mëkati kaq serioz sa që Zotit Jezus iu desh të vdiste për ne?

Nevoja për shpëtimin



Metoda: Predikim me skeçbord

Vizualet 21 dhe 23 duhet të përdoren si predikime me skeçbord.

Fjalët kryesore duhet të jenë në katrorë gjatë mësimin. Nëse nuk e njihni mirë këtë metodë, duhet të praktikoheni, para se ta bëni përpara grupit që të dini si të mbushni katrorët. Kjo metodë e të shkruarit tërheq më së miri vëmendjen e adoleshentëve. Një ide tjetër do të ishte ta reduktonit vizualin dhe t'ia jepni adoleshentëve që të provojnë ta bëjnë vetë.

1. Mëkati na ndan nga Perëndia

Qëkur Adami dhe Evanuki u bindën Perëndisë në Kopshtin e Edenit, çdo njeri në botë ka lindur me një natyrë mëkatore. Pasoja më e tmerrshme e mëkatit është se ai na shkëput nga Perëndia (Isaia 59:2). Të njohësh Perëndinë është gjëja më e rëndësishme dhe e mrekullueshme në jetë – ky duhet të jetë qëllimi

NDARJE

ynë. Por Perëndia është i drejtë dhe i shenjtë dhe nuk mund ta durojë mëkatit në praninë e Tij (Habakuku 1:13a). Për këtë arsye ne e dimë se mëkatat, ndërsa janë akoma në mëkat, nuk mund t'i afrohen kurrë një Perëndie të shenjtë. Nëse qëndrojmë në mëkat, kjo ndarje është e përjetshme dhe do të kalohet në ferr (Romakëve 6:23). Ne e dimë nga Bibla se jemi të ndarë nga Perëndia, por e dimë këtë edhe nga përvoja. Mendimet dhe veprimet tona na tregojnë se jemi larg Perëndisë. Ne jemi të pakënaqur nga brenda dhe do të mbetemi kështu derisa ta njohim Perëndinë.

2. Mëkati na bën skllavër

SKLLAVËRI

Ne jo vetëm që ndahemi nga Perëndia për shkak të mëkatit, por edhe jemi në robëri për shkak të mëkatit tonë (Gjoni 8:34). Mëkati nuk është thjesht një gabim apo zakon i jashtëm por është një prishje e thellë e brendshme. Ne nuk mund ta heqim atë me forcat tona. Mëkatet tona të jashtme janë shenja të një sëmundjeje të brendshme. Ne duhet të kuptojmë se si jemi, por më e rëndësishme është që jetët tona duhet të ndryshojnë me anë të Krishtit dhe të çlirohen nga kjo skllavëri.


3. Mëkati i prish jetët tona

JETË E PRISHUR

Gjëja e parë që Perëndia do për jetët tona është që ta duam Perëndinë të parin, të tjerët pas Tij dhe veten në fund. Mëkati e kthen mbrapsht këtë renditje duke e vendosur veten të parin. Perëndia na ka dhënë gjithashtu standarde, Dhjetë Urdhërimet. Kur ne i shkelim ato, jetët tona prishen dhe shëmtia e mëkatit mund të shihet në ne.

Metoda: Mëkati dhe pasojat e tij


Kjo metodë do t'i ndihmojë adoleshentët që të mendojnë mbi mënyrën se si ndikon mëkati në jetët dhe marrëdhëniet e tyre dhe i prish ato.



Fotokopjoni vizualin 22 mbi karton. I pritni copat e ndryshme dhe i bashkoni me disa fije si në figurën që ndodhet poshtë: A1 me B1 dhe C1, A2 me B2 dhe C2 etj. Është mirë të keni fije të gjatësive të ndryshme nga 5 në 30 cm. I vini

të gjitha në një zarf të madh duke lënë vetëm kartat A pak jashtë. Një adoleshent do të marrë një kartë A, do ta lexojë dhe do ta tërheqë fijen për të gjetur pasojat mbi kartat B dhe C. Vini re në vizualin 2 se A4, B4, dhe C4 janë bosh. Ju mund t'i pyesni vetë adoleshentët që të gjejnë një shembull dhe ta shkruajnë.

Jezusi ka folur shumë qartë për natyrën tonë të vërtetë (Marku 7:21-23). Kjo pamje e mëkatit




që prish jetët tona është mjaft ndryshe nga mënyra joshëse me të cilën shpesh mëkati na portretizohet në media.

Pra, mëkati na ndan nga Perëndia, na bën skllavër dhe prish jetët tona. Në këtë mënyrë mëkati paraqitet ashtu si është në të vërtetë dhe na tregon sesa serioz është. Ne nuk mund të bëjmë dot gjë për mëkatit tonë me forcat tona. Por Perëndia bëri diçka. Ai dërgoi Zotin Jezus që të vdiste për mëkatit tonë.

NDARJA E MËSIMIT

Udha e shpëtimit



Katër fjalë mund të përdoren për të përshkruar atë që Jezusi kreu në kryq (përdorni vizualin 23).

1. Flijim

FLIJIM

Zoti Jezus ishte një flijim. Le të lexojmë

Hebrenjve 9:26. Dhjata e Vjetër na ndihmon që të kuptojmë këtë ide të flijimit. Një qengj i vogël i përsosur duhet të therej dhe gjaku i tij duhet të derdhej. Ky ishte flijimi i urdhëruar nga Perëndia për të bërë shlyerjen e mëkatit. Me fjalë të tjera, njerëzit ishin “një” me Perëndinë. Sigurisht që nuk kishte shpëtim në gjakun e kafshëve (Hebrenjve 10:4), por ato paratregonin flijimin e Krishtit në kryq (1 Pjetër 1:18-19). Ata që kanë besim te Krishti nuk janë më të ndarë nga Perëndia prej mëkatit të tyre, por janë “një” me Perëndinë.

2. Mbjalti mëkatin

MBAJTI

MËKATIN

Krishti mbajti mëkatet tona. Përsëri në Dhjatën e Vjetër na jepet një ide e mbajtjes së mëkatit prej atyre që nuk i binden Zotit (Levitiku 5:17). Është e njëjta gjë edhe sot. Nëse shkelim ligjin e Perëndisë ne e meritojmë ndëshkimin tonë të drejtë. Por Zoti Jezus, Ai që është Perëndi dhe jetoi

një jetë të përsosur, e mori ndëshkimin e mëkatit tonë dhe kështu Ai u bë mbajtësi i mëkateve tona. Le të lexojmë 1 Pjetrit 2:24. Nëse nuk e pranojmë Krishtin dhe veprën e Tij të përfunduar në kryq, atëherë ne do të vuajmë ndëshkimin e mëkateve tona për tërë përjetësinë (Romakëve 6:23).

3. Vuajti

Në të gjitha këto Krishti vuajti për ne. Le të

VUAJTI

lexojmë 1 Pjetrit 3:18. Ne pamë vuajtjet e jetës së Tij, por agonia që Krishti vuajti nga ora e tretë në orën e nëntë është e papërshtueshme me fjalë. Ishte vuajtja fizike për shkak të kurorës me gjemba, të shkullurit të mjekrës, rrahjet, pështymat, talljet, mohimi, gozhdët në duart dhe këmbët e Tij dhe dhembjet e tmerrshme të qëndruarit i varur në kryq. Por kjo nuk mund të krahasohet me agoninë e të qenit flijim dhe mbajtës i mëkateve të njerëzimit. Ai u bë mëkat për ne, pavarësisht nga fakti se Ai nuk kishte mëkatuar kurrë (2 Korintasve 5:21). Ai u braktis nga Perëndia (Mateu 27:46). Ai duroi vuajtjet e ferrit. Se si Perëndia mund të braktisë Perëndinë nuk mund të kuptohet, por e mrekullueshmja është që Ai e bëri këtë për ne! Pastaj, te Lluka 23:46, ne lexojmë se Ai vdiq. Ai e bëri gjithë këtë vullnetarisht – Ai e dha Vetën për ne. Ai duroi ndëshkimin e ndarjes nga Perëndia të cilin e meritonin mëkatet tona.

4. E mjaftueshme

MJAFTON

Një aspekt mjaft i rëndësishëm dhe i fundit i vdekjes së Krishtit është që ishte e mjaftueshme. Ne shpëtohemi nga hiri e jo veprat. Shikoni Efesianëve 2:8–9. Megjithatë

ne akoma mendojmë se duhet ta meritojmë shpëtimin tonë. 1 Pjetrit 3:18 e bën të qartë se ajo që Krishti bëri është e mjaftueshme. Ajo nuk ka pse të përsëritet më dhe as nuk mund të përmirësohet a t'i shtohet diçka. Është e plotë. Fjalët e fundit të Jezusit në kryq ishin "U krye!" (Gjoni 19:30). Asnjë vepër e mirë, të shkuarit në shtëpinë e Perëndisë, prindërit e krishterë, vetë-ndëshkim, sakrament fetar, ose ndonjë gjë tjetër nuk mund t'i shtojë apo t'i heqë vdekjes flijuese të Krishtit në kryq. Të sugjerosh këtë ide është një shkelje ndaj Perëndisë, sepse vdekja e Jezusit ishte krejtësisht e mjaftueshme për shlyerjen e mëkateve tona. Ne e dimë se Jezusi nuk qëndroi i vdekur – Perëndia e ringjalli atë, duke provuar kështu se flijimi i tij ishte i mjaftueshëm në sytë e Perëndisë (Romakëve 4:24-25).

PËRGJIGJET E MATERIALIT 13

Plotësoni vendet boshe: Ndan; ekziston një hendek i madh midis qiellit e ferrit që është i pakapërcyeshëm; skllëvër; vetëm Jezusi që është e Vërteta mund të na çlirojë nga zgjedha e mëkatit; prish; mendime të këqija, kurorëshkelje, imoralitet, vrasje, vjedhje, lakmi, etj.; flijimi; vuajti; mbajtës i mëkateve; e mjaftueshme.

Metoda: Fletë pune

Shikoni vargjet, plotësoni fjalët që mungojnë dhe përgjigjuni pyetjeve.

Linku 16:19-25 **Mëkati na** nga Perëndia.
Pse duhet të shtohet?

Gjoni 8:31-36 **Mëkati na bën**.
Si mund të shpëtohet?

Almeti 7:21-23 **Mëkati** jetët tona.
Çfarë do të ngjarë sikur asnjë mëkati?

Materiali 13





Fotokopjoni materialin 13 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Kjo do t'i ndihmojë që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.

Përfundimi

Orët që Krishti kaloi në kryq janë pa dyshim orët më të rëndësishme të historisë së botës. Ai e bëri të mundur që ne të shpëtohem nga mëkatet tona dhe të pajtohemi me Perëndinë. Si mund të shpëtoheni? Duke ardhur tek Zoti Jezus, duke i besuar Atij (Veprat 16:31) dhe duke u penduar nga mëkatet (Veprat 3:19). A e keni bërë këtë? Nëse po, atëherë jeni të falur dhe keni një marrëdhënie me Perëndinë. Ndoshta ju nuk doni t'ia dini për atë që bëri Jezusi në kryq për ju. Ose ndoshta ju keni dëgjuar për të shumë herë por nuk i jeni përgjigjur asnjëherë. Ejani tek Zoti Jezus Krisht sot. Gjithçka që Ai bëri ishte për ju. ●

Ringjallja e Tij

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë se ringjallja e Krishtit është e themeluar mirë dhe se teoritë kundërshtuese nuk janë të qëndrueshme.
-  Të kuptojnë se ringjallja është një themel i besimit të krishterë – ajo vërteton Hyjninë e Krishtit, por edhe shpëtimin dhe jetën e përjetshme nëpërmjet Tij.
-  Të jenë gati që t'u shpjegojnë të tjerëve pse ata besojnë se Jezusi është i gjallë dhe pse është aq shumë e rëndësishme.
-  Të kthehen tek Shpëtimtari i gjallë.

Hyrja: Zoti Dyshimi dhe Zonjusha Siguria

Përgatitni një skeç të vogël. Zoti Dyshimi dhe Zonjusha Siguria takohen.


- Zjsh. Siguria: “Gëzuar Pashkën, zoti Dyshim! A nuk është fantastike të dish që Jezusi është i gjallë?”
- Z. Dyshim: “Mirë, zjsh Siguri, po disa njerëz nuk besojnë se Jezusi është ringjallur prej së vdekuri. Unë nuk jam vetë shumë i sigurt...”
- Zjsh. Siguria: “Nuk je? Po çfarë thonë këta njerëz?”
- Z. Dyshim: “Disa njerëz thonë se Maria shkoi në varrin e gabuar. Të tjerë besojnë se Jezusi nuk vdiq – vetëm sa i ra të fikët. Ndoshta dikush mund ta ketë vjedhur trupin. Nuk e di se çfarë të them për këtë...”
- Zjsh. Siguria: “Ju duhet të zbuloni se çfarë ka ndodhur në të vërtetë! Nëse Krishti nuk është ringjallur, besimi ynë është i kotë! Unë sugjeroj të lexoni Gjoni 20?”

Zonjusha Siguria citoi 1 Korintasve 15:14 “Por në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, predikimi ynë është i kotë dhe i kotë është edhe besimi juaj”. Ne duhet të kemi besim te Krishti dhe kjo do të thotë të besosh në ringjalljen e Zotit Jezus Krisht prej së vdekuri. Ne duhet ta ushtrojmë besimin tonë por ka gjithashtu prova të jashtëzakonshme për të mbështetur këtë ngjarje të mbinatyrshme. Le të lexojmë Gjoni 20:1-8. Ky pasazh jep katër prova të ringjalljes.

1. Varri ishte i zbrazët-thuajse!

Maria Magdalena, Pjetri dhe Gjoni zbuluan se guri ishte lëvizur dhe varri ishte i zbrazët. Kjo është një provë aq e fortë e ringjalljes saqë jobesimtarët sajuan një sërë teorish që ta shpjegonin. Ndoshta ju keni dëgjuar për disa prej këtyre teorive – si zoti Dyshim – dhe jeni hutuar pak.

Metoda: Flluska fjalësh



Grupi të imagjinojë që zoti Dyshimi dhe zonjusha Siguria vazhdojnë bisedën e tyre mbi ringjalljen.

Paraqitni vizualin 24. Lexoni thënien e parë të zotit Dyshim dhe nxitini adoleshentët të mendojnë se si do të përgjigjet zonjusha Siguria. Njëvullnetar mund të dalë e të shkruajë përgjigjen në flluskën me fjalë të zonjushës Siguria. Bëni të njëjtën gjë me dy thënie pasuese.

- Një teori është që gratë shkuan tek varri i gabuar. Edhe sikur kjo të ishte e vërtetë nuk ka të ngjarë që Maria të jetë kthyer më vonë në dritën e diellit te varri i gabuar. Do të ishte një ko incidencë e kotë që Pjetri dhe Gjoni të bënin të njëjtin gabim.
- Të tjerë thonë se Jezusi nuk vdiq në kryq, por vetëm sa i ra të fikut. Por ushtarët romakë që ishin caktuar për ekzekutimin ishin të regjur për të gjykuar nëse njerëzit ishin të vdekur apo jo. Shtiza në ijë do ta kishte vrarë me siguri.
- Të tjerë thonë se trupi ishte vjedhur, por nga kush? As hajdutët e as dishepujt nuk mund ta kishin bërë këtë për shkak të rojeve të fuqishme romake (Mateu 27:62-66). Po ta kishin marrë autoritetet trupin, ata do ta kishin nxjerrë një ditë për të ndalur predikimin e dishepujve. Ata në fakt sajuan një gënjeshtër se gjoja e kishin vjedhur trupin, të cilën judejtë e besojnë edhe sot e kësaj dite (Mateu 28:15). Trupi i Zotit nuk u hoq nga njerëzit, por u ringjall nga Perëndia!

Sidoqoftë një gjë ndodhej në varr – pëlhurat e varrimit, ende të palosura siç kishin qenë përreth trupit. Asnjë vjedhës varresh nuk do t'i kishte lënë në atë mënyrë! Kishte diçka aq të veçantë mbi to sa që kur Gjoni i pa ato, ai besoi (Gjoni 20:6-8).

2. Zoti iu shfaq dëshmitarëve

Jezusi iu shfaq së paku dhjetë herë njerëzve, vetëm, dy vetave apo në grupe të mëdha. Megjithatë kritikët kërkojnë argumente për ta kundërshtuar këtë dhe thonë se të gjithë po kërkonin Jezusin dhe e ngatërruan me një tjetër. Por kjo nuk është e vërtetë. Si ndjeheshin dishepujt? Të frikësuar, me dyshime, të dëshpëruar dhe të shpërndarë. Thomai nuk u besonte dishepujve të tjerë

derisa e pa vetë Jezusin. Dy dishepujt në rrugën për në Emaus, ishin trishtuar nga ngjarjet e kryqëzimit dhe po ktheheshin në shtëpi (Lluka 24:17). Ata kishin dëgjuar për ringjalljen e Tij (Lluka 24: 22-24), por asgjë nuk na tregohet nëse ata shkuan për të kontrolluar, kaq mosbesim kishin ata. Çfarë e shtyu Marinë, Thomain dhe dy dishepujt në rrugën për në Emaus që të besonin? Ajo që u tha dikush? Jo! Vetëm shfaqjet e Vetë Zotit Jezus i bënë ata që të besonin. Zoti Jezus na thotë: “lum ata që nuk kanë parë dhe kanë besuar!” (Gjoni 20:29).

Metoda: Në kërkim të të dhënave!

Të kërkojmë për të dhëna

1. Përdorni kërkuesin e fjalëve të kësaj Bibele.
2. Shprehni pyetjen tuaj në fjalë të thjeshta.
3. Klikoni në "Kërkoni" ose "Kërkoni të gjitha".
4. Shikoni rezultatet dhe klikoni në "Kërkoni më tej".
5. Shikoni rezultatet dhe klikoni në "Kërkoni më tej".
6. Shikoni rezultatet dhe klikoni në "Kërkoni më tej".

Vizuall 25

Meqë kjo lojë është e gjatë dhe tërheqëse, mund ta lini për në fund të mësimit që të mos e prishni rrjedhën e studimit. Ndajini adoleshentët në grupe me nga tre veta. Ata do të gjejnë se kujt iu shfaq Zoti i ringjallur pas ringjalljes. Fotokopjoni vizualin 25 mbi karton dhe pritni nëntë kartat. I vini përreth mureve, ndonëse jo në renditjen e duhur. Fotokopjoni materialin 14 dhe i jepni secilit grup një “fletë me të dhëna” një laps dhe një Bibël. I nisni grupet në intervale prej 30 sekondash. Ata duhet të vrapojnë përreth, të lexojnë kartat dhe të plotësojnë fletat sa më shpejt të jetë e mundur.

Të kërkojmë për të dhëna

1. Përdorni kërkuesin e fjalëve të kësaj Bibele.
2. Shprehni pyetjen tuaj në fjalë të thjeshta.
3. Klikoni në "Kërkoni" ose "Kërkoni të gjitha".
4. Shikoni rezultatet dhe klikoni në "Kërkoni më tej".
5. Shikoni rezultatet dhe klikoni në "Kërkoni më tej".
6. Shikoni rezultatet dhe klikoni në "Kërkoni më tej".

Materiali 14

3. Dishepujt u shndërruan

Pjetri kishte qenë i pari që e kuptoi se kush ishte Jezusi kur bëri atë deklaratë të mrekullueshme: “Ti je Krishti, Biri i

Perëndisë së gjallë” (Mateu 16:16). Pjetri tha se nuk do ta mohonte kurrë që ishte një ndjekës i Jezusit, por ai e bëri këtë tre herë me radhë. Pas kryqëzimit, besimi i tij u trondit seriozisht. Atë natë ai po fshihej prapa dyerve të mbyllura. Por pas disa javësh ai predikoi para mijëra vetave. Te Veprat 4 Pjetri qëndroi para Sinedrit (udhëheqësve judej) dhe foli për Zotin. Ishte ringjallja që solli ndryshimin dhe nga ajo kohë predikimi i ungjillit u fokusua në vdekjen dhe ringjalljen e Zotit Jezus.

A kishin predikuar dishepujt një përrallë? A kishin vuajtur dhe vdekur si martirët, siç ndodhi me shumicën e tyre, thjesht për një histori të trilluar? Jo! Ata e panë Zotin dhe kjo solli ndryshimin.

4. Dita e adhurimit ndryshoi

Shabati i judejve ishte ngulitur prej brezash të tëra tek ta. Vënia mënjane e ditës së shtatë ishte fiksuar në traditën fetare. Megjithatë nga fillimi ne shohim të krishterë, ndonëse judej, që fillojnë e adhurojnë ditën e parë të javës. Kjo shpjegohet vetëm nga fakti se Jezusi u ringjall ditën e parë të javës. Historia mund të ndryshohej vetëm nga një ngjarje historike!

Këto janë disa prova të ringjalljes.

Sër Edmond Klark, (këshilltari i mbretit, ofiqi më i lartë në ligj në Britani) ka shkruar si më poshtë: “Si jurist, unë kam kryer një studim të zgjeruar të provave të ditës së parë të Pashkës. Për mua provat janë vendimtare dhe në shumë raste në Gjykatën e Lartë, kam marrë vendime në bazë të provave që kanë qenë më pak bindëse. Unë i pranoj pa rezervë si një dëshmi të njerëzve të besueshëm të fakteve që ata mund t’i provonin më së miri”.

Provat janë të fuqishme por ju gjithashtu duhet t’i pranoni me besim.

NDARJA E MËSIMIT

Është jetike që të besoni se Jezusi është ringjallur. Shumë të vërteta që ne besojmë bien ose qëndrojnë me ringjalljen. Ringjallja është një garanci e këtyre të vërtetave. Ne do të shohim katër prej tyre.

Metoda: Stampim



Zmadhoheni vizualin 26 në letër dhe pritni katër rrrathët që ndodhen në pjesën e poshtme të faqes. I ngjitni ata në etiketa dhe ua jepni katër adoleshentëve. Në kohën e përshtatshme, ata duhet të lexojnë vargun që tregohet në

etiketë dhe pastaj ngjitni etiketën mbi vizual në vendin e duhur. Është si t’i stamposh këto të vërteta për të treguar se janë të garantuara nga ringjallja.

1. Garancia për hyjninë e Krishtit

Ne kemi parë tashmë provat mbi hyjninë e Krishtit nga Shkrimi, por nëse ai është ringjallur atëherë kjo i vulos shpalljet e Tij. Pali, që e dinte se Jezusi është ringjallur, shkruan tek Romakëve 1:4 se Jezusi ishte “i deklaruar Biri i Perëndisë në fuqi, sipas Frymës së shenjtërisë nëpërmjet ringjalljes prej së vdekurit”. Pali është duke thënë thjesht që meqenëse Jezusi është ringjallur, Ai është Perëndi. Te Mateu 12:38 skribët e farisejtë kërkuan për një shenjë dhe Jezusi u përgjigj: “Në fakt ashtu si Jona qëndroi tri ditë e tri net në barkun e peshkut të madh, kështu Biri i njeriut do të qëndrojë tri ditë e tri net në zemër të tokës” (Mateu 12:40). Jezusi e përmbushi atë premtim duke u ringjallur ditën e tretë pas kryqëzimit.

2. Garancia për shpëtimin

Ne kemi parë se si Krishti vdiq si flijimi ynë, por nga e dimë nëse ky flijim ishte i pranueshëm para Perëndisë? Te Romakëve 4:25 ne lexojmë se Jezusi “u dha për shkak të fyerjeve tona (u dënua me vdekje për mëkatet tona) dhe u ringjall për shfajësimin tonë (për shpëtimin tonë). Prandaj ringjallja është deklarimi i Perëndisë se Ai e ka pranuar flijimin e Jezus Krishtit për mëkatet e njerëzve. Për tre ditë pyetja mbeti pa përgjigje e pastaj Perëndia e ringjalli Zotin Jezus prej së vdekurish. Tani Jezusi është i lartësuar në të djathtë të Atit.

3. Garancia për jetën e përjetshme

Ringjallja provon që vdekja nuk është fundi. Zoti Jezus na ka premtuar dy gjërat e mëposhtme.

1. Ai do të kthehet përsëri për ata që i besojnë Atij (Gjoni 14:3).
2. Trupat e atyre që janë besimtarë dhe kanë vdekur do të ringjallen që të jenë me Të përgjithnjë (1 Thesalonikasve 4:14).

Kur u ringjall Ai e vërtetoi se ishte e mundur. Zoti Jezus gjithashtu na ka thënë ne që e njohim Atë si Zot dhe Shpëtimtar disa fjalë inkurajuese: “sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni” (Gjoni 14:19).

4. Garancia për gjykimin

Veprat 17:13 përmban një paralajmërim mjaft serioz se bota do të gjykohet nga Zoti Jezus, të Cilin Perëndia e ka ringjallur prej së vdekuri. Krishti ka folur edhe për gjykimin e fundit, duke shpallur se do të jetë gjykatësi. Ringjallja provon se Ai e ka përmbushur shpalljen e Tij. Njerëzit u gëzuan nga vdekja e Tij. Ata menduan se e dënuan Atë një herë e përgjithmonë dhe mbaruan punë, por një ditë ata duhet të përballen me Të përsëri. Dhe po ashtu, edhe ju e unë (Hebrenjve 9:27).




Përfundimi

Këto janë katër të vërteta kryesore të Ungjillit për të cilat ringjallja është një garanci. Kur shohim provat për ringjalljen, kjo çon me siguri tek fakti që ne me të vërtetë mund t'u besojmë këtyre të vërtetave.

Por, asnjëra prej tyre nuk do t'ju vlejë, nëse nuk e keni vënë besimin tek Shpëtimtari i ringjallur. Ai është përgjigja e nevojave tuaja. Ne kemi parë Hyjninë, jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Tij. Ai jeton sot dhe ju mund të jeni me Të përgjithnjë. Çështja është: “A dëshiron ti?” ●

A jeni të shpëtuar?

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të krahasojnë princin e ri me Nikodemin dhe të mendojnë mbi përgjigjen e tyre ndaj Ungjillit.
-  Të kuptojnë se gjëra të ndryshme mund t'i pengojnë ata për të ndjekur Krishtin, ashtu siç bëri paraja në rastin e princit të ri.
Të jenë si Nikodemi, një dishepull që qëndron fort për Zotin.
-  Të vendosin besimin e tyre te Krishti dhe të marrin një jetë të re dhe të përjetshme.

Hyrja: Po më pas?

Fillojeni studimin duke luajtur rolin e një reporteri. Pa i paralajmëruar adoleshentët më parë, shkoni tek ata sikur të ishin njerëz të famshëm dhe u bëni pyetje. Përdorni një mikrofon.

- Përgëzime! Ju sapo keni fituar garën e 100 metërshit dhe keni thyer rekordin botëror. Çfarë keni ndër mend që të bëni tani?
- Tani duhet të jesh i/e lehtësuar! Kalove me sukses një operacion zemre. Çfarë do të bësh kur të dalësh nga spitali?
- I gjithë vendi të ka zili! Ti sapo fitove në një program televiziv! Çfarë do të bësh me paratë e fituara?
- Ti ke shpenzuar një vit të tërë në këtë grup. Çfarë do të bësh si reagim ndaj mësimin që ke marrë?

Këtë vit ne kemi par disa të vërteta të rëndësishme! Cilat? (Le të përmendin disa adoleshentët. Pastaj bëni një përsëritje të shpejtë duke përdorur vizualin përmbledhës).

- Bibla nuk është një libër i mërzitshëm e jashtë mode, por është mesazhi aktual i Perëndisë së gjallë. Ai është i fuqishëm, përfitues, personal, praktik dhe frytdhënës.
- Ne kemi kaluar kohë duke zbuluar se Dhjetë Urdhërimet janë ende shumë aktuale për ne. Ata na tregojnë se sa mëkatarë jemi ne dhe zbulojnë nevojën që kemi për një Shpëtimtar.
- Ne kemi studiuar hyjninë, jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Ai mund të na shpëtojë sepse Ai është Perëndia Biri dhe i ka zbatuar me përpikmëri urdhërimet.

Cili është reagimi juaj ndaj këtyre? A keni menduar me të vërtetë për këtë? Ne do të shohim dy persona që kanë menduar për reagimin e tyre.

Djaloshi i ri pasanik: Marku 10:17-22



(Ju duhet të zbuloni tekstin e vizualit 27 pak nga pak ndërsa bëni komente mbi pasazhin.

Paraqiteni vizatimin vetëm kur e të bëni zbatimin në jetën e adoleshentëve).

Një ditë, menjëherë pasi Jezusi kishte shpenzuar një farë kohe me një grup prindëresh me fëmijët, një djalosh rëndi tek Ai. Djaloshi i ra në gjunjë duke e pyetur se çfarë duhet të bëjë që të ketë jetën e përjetshme. Le të lexojmë te Marku 10:17-22. Jezusi e drejtoi të riun tek disa

prej Dhjetë Urdhërimeve dhe tek njëri prej urdhërimeve kryesore. (Lexoni përsëri Marku 10:19 dhe referojuni Mateu 19:18). I riu e njihte Ligjin dhe tha se e kishte zbatuar atë që kur kishte qenë fëmijë. Me këtë ai tregoi se nuk i kuptonte shumë urdhërimet. Ne kemi zbuluar se ata na tregojnë se sa mëkatarë jemi dhe se është e pamundur që ne t'i zbatojmë të gjitha. Por ai mendonte apo pretendonte se i kishte zbatuar. Ç'marrëzi!

Megjithëse djaloshi i kishte thënë Zotit Jezus diçka të gabuar, Bibla na tregon se Jezusi e donte atë. Mbajeni mend gjithnjë që megjithëse nuk e keni arritur standardin e përsosur të Perëndisë, Perëndia akoma ju do dhe dëshiron që ju të vini tek Ai. Perëndia e donte këtë djalosh dhe donte më të mirën për të. Por ndërsa lexojmë tregimin shohim se diçka e mbante larg Perëndisë.

Zoti Jezus i tha që të shkonte e të shiste gjithçka që kishte dhe t'ua jepte paratë të varfërve e pastaj të vinte e ta ndiqte Atë. Djaloshi, edhe pse ishte i ri, ishte mjaft i pasur dhe i donte shumë paratë. Marku 10:22 është një nga vargjet më tragjike në tërë Biblën. Na tregohet në të se si u vrenjt fytyra e djaloshit dhe ai u largua i trishtuar. Ai e kishte gabim. Ai mendonte se të zbatuarit e urdhërimeve do ta bënte të drejtë para Perëndisë. E vërteta ishte se ai kishte një idhull të cilin nuk donte ta dorëzonte. Ky idhull ishte paraja. Në vend që të largohej nga idhulli ai u largua nga Perëndia. Ai donte jetën e përjetshme por nuk ishte gati që të hiqte dorë nga një idhull i botës dhe ta vinte të parin Perëndinë. Asgjëkund në Dhjatën e Re nuk lexojmë më për këtë djalosh.

Kjo histori tragjike ka një mesazh mjaft serioz për ne. Edhe sot shumë njerëz kanë një mendim të lartë për vetveten dhe besojnë se mund ta fitojnë shpëtimin e tyre. A mendoni në këtë mënyrë? Mbani mend se ju nuk mund t'i bindeni plotësisht ligjit të Perëndisë.

Paraja është ende një idhull që i ka larguar shumë njerëz nga Perëndia. A ka diçka në jetën tuaj që ju ndalon që ta ndiqni Zotin? Sigurohuni që të mos ndodhë! Mos lini asgjë që t'ju pengojë që të ndiqni Perëndinë.

Metoda: fjalë të përziera

I shkruani këto fjalë të përziera mbi një tabelë dhe lërini adoleshentët të përpiqen për t'i gjetur ato. Kjo do t'i shtyjë të mendojë se çfarë mund t'i pengojë që të jetojnë për Krishtin. Përgjigje: shokët, paratë, popullariteti, karriera, familja e zotërimet.


ËOTSKH ËAPATR
TAITOUPLPREI RAIRKAER
IAFMAJL
TOËTZIREM

NDARJA E MËSIMIT

Nikodemi: Gjoni 3:1-21

Nikodemi
E njihte ligjin
E kuptoi nevojën e tij
Kështu shpëtim
Vizuali 28
kës

A ËSHTË KY QËNDRIMI Y?



(Ju duhet të zbuloni tekstin e vizualit 28 gradualisht në dërrsa komentoni mbi pasazhin.

Paraqiteni vizatimin vetëm kur të bëni zbatimin ndaj jetës së adoleshentit].

Herët në shërbesën e Jezusit në tokë ishte një person tjetër që ishte i interesuar për Të dhe atë që Ai kishte për të thënë. Emri i tij ishte Nikodem. Lexoni Gjoni 3:1-4. Nikodemi ishte një udhëheqës fetar dhe duhet t'i njihte urdhërimet shumë mirë. Ai po përpiquej të jetonte për të kënaqur Perëndinë, por e kuptonte se mungonte diçka. Ai e kuptoi se kishte diçka të veçantë tek Jezusi dhe se Perëndia ishte me Të. Një natë Nikodemi

kaloi fshehurazi nëpër rrugët e Jeruzalemit për të folur me Jezusin mbi këto gjëra të rëndësishme.

A është ky qëndrimi juaj? Ndoshta ju e kuptoni se diçka thelbësore mungon në jetën tuaj. Ju e pranoni se nuk jeni të aftë për t'iu bindur urdhërimeve të Perëndisë. Dëgjojeni Zotin Jezus siç bëri Nikodemi.

Jezusi kishte një përgjigje për problemin e Nikodemit, por jo atë që ai priste. Jezusi i tha Nikodemit se duhet të rilindte. Nikodemi mendonte se ishte e pamundur që një plak të rilindte. Jezusi ia shpjegoi se çfarë donte të thoshte. Nikodemi nuk duhet të bëhej përsëri një foshnje, por duhet të kishte një jetë të re frymërore. Ai duhet të t'i vinte gjërat në rregull me Perëndinë. Le të lexojmë vargjet 16-18. Nikodemi mund ta kishte këtë jetë të re vetëm duke besuar tek Biri i Perëndisë. Do të ishte një jetë që do të zgjaste përgjithnjë.

Zoti i tha Nikodemit se ata që besojnë tek Jezusi nuk dënohen. Ai i tha edhe se ata që nuk besojnë janë të dënuar. Ne nuk lexojmë se Nikodemi i besoi Krishtit që atë çast. Por e dimë nga referenca të tjera në Dhjatën e Re se Zoti e ndryshoi atë.

Metoda: Kërkime në grup

Ndajini adoleshentët në grupe me nga tre ose katër. Ata duhet të lexojnë Gjoni 7:45-52 dhe Gjoni 19:38-42 dhe t'u përgjigjen dy pyetjeve. Çfarë bëri Nikodemi në këto rrethana të vështira? Çfarë zbulon qëndrimi i tij mbi jetën e tij frymërore?

Nikodemi qëndroi për Jezusin në sinagogë përpara kolegëve të tij që e urrenin Jezusin. Ndërsa të tjerët ishin të fshehur, Nikodemi nuk pati turp që ta merrte trupin e Zotit Jezus nga kryqi dhe ta vendoste në një varr. Ai ndryshoi dukshëm nga koha kur kaloi fshehurazi në rrugët e Jeruzalemit për një takim sekret me Jezusin. Tani ishte një ndjekës i hapur i Krishtit.

Nikodemi ishte larguar nga përpjekja për të fituar shpëtimin e tij nëpërmjet të qenit një person shumë fetar. Ai u largua nga mëkati dhe u kthye te Zoti Jezus, i besoi Atij për shpëtim dhe ishte një njeri i shndërruar.

Metoda: Intervistë

Ju mund të ftoni një të krishterë që të ndajë dëshminë e tij me grupin. Për ta bërë sa më të gjallë, bëjeni si intervistë. Bëni disa pyetje në lidhje me studimin, p.sh. "Kur ti erdhe te Krishti, a kishte ndonjë gjë të vështirë prej së cilës duhej të hiqje dorë? Çfarë ndryshimesh ndodhën në jetën tënde kur rilinde?" Vizitori duhet t'i marrë pyetjet që më parë, në mënyrë që të përgatisë përgjigjet. Zgjidhni dikë që mund të komunikojë mirë me adoleshentët. Nëse nuk gjeni ndonjë të disponueshëm, mund të jepni dëshminë tuaj dhe të intervistoheni nga një prej adoleshentëve.

Metoda: Fletë pune

Fotokopjoni materialin 15 për të gjithë adoleshentët. Ata mund ta plotësojnë atë gjatë programit ose më vonë në shtëpi. Kjo do t'i ndihmojë ata që të përsëritin mësimin dhe të mësojnë përmendësh pikat kryesore.

Përfundimi

Me cilin prej këtyre dy personave ngjan më shumë ti? Ata ishin të ngjashëm në shumë drejtime. Ata të dy e njihnin ligjin e Perëndisë dhe mundoheshin ta respektonin atë. Ata e panë Jezusin si një person të cilin mund ta pyesnin mbi jetën dhe përjetësinë. Ata të dy erdhën e i folën Atij. Këtu përfundon ngjashmëria. Të dy kishin reagime mjaft të ndryshme. Njëri u largua nga Perëndia

dhe humbi. Njëri u kthye te Perëndia dhe shpëtoi.

Ndoshta ju po bëni të njëjtin gabim që ata të dy bënë në fillim. Ndoshta ju mendoni se duke u përpjekur për të zbatuar urdhërimet, apo për të qenë i mirë, apo për të shkuar në kishë, do të fitoni shpëtimin. Por tani e dini se nuk mund ta arrini këtë. Ju e dini se e vetmja

mënyrë për t'u shpëtuar është duke u larguar prej mëkatit dhe duke i besuar Krishtit. Të dish diçka për Jezusin nuk mjafton. Ashtu si i riu pasanik dhe Nikodemi, ju duhet të përgjigjeni. Si cili prej personave do të jeni? Jini si Nikodemi! Besojini Zotit dhe pastaj jetoni vërtetë për Të. ●



PËRGJIGJET E MATERIALIT 15





Plotësoni vendet boshe: I riu pasanik; pretendonte se bindej; donte paratë; u largua i trishtuar; Nikodemi; kuptoi nevojën e tij; kërkonte shpëtimin; u bë një ndjekës.

U largua nga Jezusi: Herodi; mbreti Agripa

U kthye te Jezusi: Sauli; Lidia

A jeni duke u rritur?

Objektivat: Ne duam që adoleshentët:

-  Të kuptojnë qëllimin e Perëndisë për fëmijët e Tij: Ai do që ata t'i qëndrojnë afër Atij dhe të rriten vazhdimisht sipas shëmbëllimit të Tij.
-  Të kuptojnë se pushimet verore mund të jenë një kohë kritike në të cilën shokët e media kanë një ndikim më të fortë e shpesh negativ.
-  Të kenë një kohë të qetë të përditshme me Perëndinë dhe t'i shërbejnë Atij gjatë periudhës verore.
-  Të kthehen te Perëndia për shpëtim.

Hyrja: Paketimi i valixheve



Apo prisni me padurim pushimet? Ndoshta po! Ta zëmë se ju po rregulloni valixhen. (Paraqitni vizualin 29). Çfarë do të vendosni që të merrni me vete?

Lexoni listën e mëposhtme të objekteve dhe le t'ju thonë

adoleshentët se cilët objekte do të donin të merrnin për pushime: orën me zile, para xhepi, libra shkolle, syze dielli, celular, parfum, Bibël, numri i telefonit të prindërve, atlete, broshura ungjilli, rroba banje, programi javor i televizionit etj.

Ajo që do të merrni varet nga ajo që keni ndër mend të bëni. Sot dua t'ju nxis që të mos ta harroni marrëdhënien me Zotin gjatë javëve në vazhdim. Vera mund të jetë një kohë e vështirë, sidomos për ata që do të kenë më pak shoqëri me të krishterët dhe më pak mësim

nga Fjala e Perëndisë.

Nëse po përpiqeni të jetoni për Zotin, ju e dini se nuk është gjithnjë e lehtë. Ashtu si një atlet duhet të mundohet shumë për të arritur synimin e tij, po ashtu edhe i krishteri duhet të punojë shumë për të arritur synimin (Filipianëve 3:14). Por cili është synimi? 2 Pjetrit 3:18 e jep një pjesë të përgjigjes. Ne duhet të bëhemi të ngjashëm me Jezusin.


Ne do shohim katër mënyra që përdor Perëndia për t'i ndihmuar besimtarët të rriten në besimin e tyre. Kjo duhet t'ju ndihmojë në jetën tuaj të krishterë gjatë muajve verorë kur nuk takohemi si grup.

Koha e qetë

Nëse ju doni të njihni Perëndinë dhe të bëheni të ngjashëm me Jezusin, ju duhet të kaloni kohë me të. Ne e quajmë kohën e kaluar në mënyrë private në praninë e Perëndisë "koha e qetë", një kohë adhurimi me Perëndinë. Ne mund të kalojmë kohë duke folur me Perëndinë nëpërmjet lutjes. Ai gjithashtu mund të na flasë përmes Fjalës së Tij ndërsa kalojmë kohë duke lexuar dhe menduar për Biblën. Pra është një komunikim i dyanshëm.

Një sugjerim për t'ju ndihmuar që të keni një jetë të rregullt lutjeje, është të mbani një ditar lutjeje. Kjo është një broshurë e ndarë në shtatë ditët e javës. (Tregoni një model). Për çdo ditë shkruani gjëra të ndryshme për të cilat doni të luteni. Disa gjëra janë për çdo ditë, disa të tjera ndoshta dy herë në javë dhe të tjera një herë në javë. Ju mund t'i shkruani përgjigjet e lutjeve dhe të shtoni kërkesa të reja që dalin.

shtyjnë shokët të shikoni! Satani mund ta përdorë median që të pushtojë mendjen tuaj. Perëndia dëshiron që ju të meditonit mbi ato që janë të pastra dhe të vërteta (Filipianëve 4:8).



Metoda: Manuali i përdoruesit

Bëni kopje të materialit 17 për të gjithë adoleshentët. I ndani në grupe prej pesë a gjashtë. Ata duhet të përgatisin udhëzime se si të përdoret sa më mirë

televizori dhe kompjuteri. Kur të kenë mbaruar, i mbliidhni, dëgjoni sugjerimet dhe u jepni disa këshilla të tjera. Disa ide të tilla janë:

Tipare të veçanta: Të shikosh televizor ose të luash me kompjuter të lejon të ...qetësohesh, të dëfresh, të mësosh, të marrësh informacione, etj.

Udhëzime sigurie: Një shikim i tepruar mund të rezultojë në ...mungesë ushtrimesh, gjumi dhe përqendrimi, më pak kohë e shpenzuar me familjen dhe shokët, etj.

Veprimi bazë: Fikeni dhe mos shikoni kur... ka dhunë, seks, reklama të vazhdueshme, etj. Mos i kontrolloni kanalet televizive se çfarë programi kanë.

Sinjali paralajmërues: Mos shpenzoni më shumë se ...një orë (apo 2 orë) në ditë.

Mundësi për të shërbyer

Një nga ndihmesat më të mëdha në rritjen sipas shëmbëllimit të Jezusit është t'i shërbesh Atij. A e kuptoni se është përgjegjësia e të gjithë të krishterëve që të ungjillizojnë? Te Marku 16:15 Zoti Jezus i urdhëron të gjithë ndjekësit e Tij që të dëshmojnë për Të. Është mirë që ju të përfshihenit në takime kishë dhe ungjillizime. Anëtarët e kishës

do të inkurajoheshin nëse do t'ju shihnin të përfshiheshit. Ju mund të përfshihenit edhe duke ndihmuar një bashkësi si Bashkësia e Ungjillëzimit të Fëmijëve dhe të merrni pjesë në një shërbesë ungjillëzuese me fëmijët.

Metoda: Prezantime shërbesash

Merrni një farë kohe për t'i paraqitur grupit mundësi të ndryshme shërbesash me kisha apo organizata misionare. Ju mund të paraqitni edhe foto ose diapozitivë, ose të ftoni dikë që mund të paraqesë një projekt, ose thjesht të ndani disa fletushka dhe t'u përgjigjeni pyetjeve që mund të kenë adoleshentët.

Ne e dimë se sa e rëndësishme është të flasësh me të tjerët, rreth Zotit Jezus. Nëse jeni gati që të shfrytëzoni raste për të dëshmuar, Perëndia do t'ua sjellë këto mundësi. Shumë njerëz që i njihni nuk do të vijnë në kishë për të dëgjuar mesazhin, por do të takohen me ju. Jetojeni jetën e krishterë përpara tyre dhe kur të vijnë mundësitë për të ndarë besimin mbështetuni tek ndihma e Zotit.

Të shërbyerit Zotit nuk është një zgjedhje – është urdhër! Ju gjithashtu duhet t'i shërbeni Atij nga dashuria për shpirtat e humbur rreth jush. Ju nuk jeni tepër të rinj për t'i paralajmëruar të tjerët për rrezikun në të cilin ndodhen pa Zotin Jezus. Ju mund të jeni nervozë, plot frikë, apo shqetësim për t'i shërbyer Zotit. Perëndia që ju ka shpëtuar është Perëndia që mund t'ju ndihmojë. Prandaj kërkoni dhe pastaj shfrytëzoni mundësi për t'i shërbyer Atij.

Përfundimi

Gjatë kësaj vere, sigurohuni që ta vini Zotin të parin në gjithçka. Ndërsa paketoni valixhen, mos harroni Biblën dhe ditarin e lutjes – duhet të keni një kohë të qetë çdo ditë me Zotin që ta njihni më mirë e të rriteni në besim.

Vendoseni Perëndinë të parin në marrëdhëniet tuaja – krijoni marrëdhënie të kënaqshme për Perëndinë. Nëse keni ndër mend që të shikoni TV ose të luani në kompjuter, mos harroni listën e udhëzimeve që përgatitëm së bashku. Ju mund t'a vini Perëndinë të parin edhe duke i shërbyer Atij – gjeni mundësi për t'u dëshmuar të tjerëve. Çfarëdo që të bëni këtë verë, konsiderojeni Perëndinë të parin. Ai do t'ju mbajë afër dhe do t'ju ndihmojë që të rriteni dhe të ecni në rrugët e Tij (Fjalët e Urta 3:5-6).

Metoda: Kuic "E vërtetë apo e rreme"

Adoleshentët të qëndrojnë në mes të sallorit apo dhomës. Lexoni një thënie siç është përmendur më poshtë. Ata duhet të vendosin nëse është e "vërtetë" ose e "rreme". Nëse mendojnë se është e vërtetë ata kalojnë në anën e sallës në të djathtën tuaj. Nëse mendojnë se është e rreme kalojnë në të majtën. Ata që gabojnë duhet të ulen dhe të shikojnë. Ata që e gjejnë saktë kthehen tek mesi dhe ju lexoni një thënie tjetër, duke përsëritur procesin derisa mbeten vetëm një ose dy. Le të ketë një çmim të vogël për fituesit. Pastaj luani për herë të dytë me të gjithë duke përdorur thëniet vijuese.

- Bibla është e fuqishme (E vërtetë)
- 2 Timoteut 3:16 na flet për doktrinën dhe qortimin (E vërtetë).
- Frytet e Frymës rreshtohen tek Kolosianëve 5:22 (E rreme).
- Fryma e Shenjtë na ndihmon të kuptojmë Biblën (E vërtetë).
- Librat e tjerë të studimit janë po aq të rëndësishëm sa Bibla (E rreme).
- Urdhërimi i parë gjendet tek Eksodi 20:2. (E rreme).
- Një pikëpamje gjysmake e Perëndisë rezulton në krijimin e një shëmbëlltyre në mendjen tonë (E vërtetë).
- Romakëve 6:23 na kujton se ne dështojmë në standardin e Perëndisë (E rreme).
- Një i krishterë që thotë gënjeshtër e keqpërdor

emrin e Perëndisë (E vërtetë).


- I shenjtë do të thotë i ndryshëm (E vërtetë).
- Urdhërimi i pestë na udhëzon që të mos vrasim (E rreme).
- Urdhërimi i gjashtë ka të bëjë me qëndrimin ashtu si dhe me veprimin (E vërtetë).
- Televizori ndikon në qëndrimin tonë ndaj urdhërimit të shtatë dhe urdhërimeve të tjera (E vërtetë).
- Kopjimi i një CD-je është shkelje e urdhërimit të nëntë (E rreme).
- Reklamat na inkurajojnë që të shkelim urdhërimin e dhjetë (E vërtetë).
- Shpallja mahnitëse e Jezusit ishte që Ai ishte si Moisiu (E rreme).
- Emri "Krisht" do të thotë "Shpëtimtar" (E rreme).
- Koha e lindjes së Jezusit është profetizuar (E rreme).
- Jezusi lutet për besimtarët sot (E vërtetë).
- Jezusi kishte ndjenja njerëzore dhe ishte ende Perëndi (E vërtetë).
- Hebrenjve 12:26 flet për flijimin e Jezusit për mëkatën (E rreme).
- Jezusi u braktis një herë nga Perëndia Ati (E vërtetë).
- Pjetri arriti te varri para Gjonit mëngjesin e ringjalljes (E rreme).
- Shumë prej dishepujve u martirizuan (E vërtetë).
- Judejtë adhuronin në ditën e shtunë (E vërtetë).
- Jezusi ia bëri të lehtë djaloshit të pasur për ta pranuar atë (E rreme).
- Nikodemi e vuri trupin e Jezusit në varrin e vet (E rreme).
- Pasi dëgjoi Jezusin, i riu pasanik dhe Nikodemi u larguan të dy (E vërtetë).
- Si i krishterë ne nuk duhet të kemi asnjë shok të pa shpëtuar (E rreme).
- Fjalët e Urta 3:5-6 na tregojnë se Fjala e Perëndisë është një llambë për këmbët tona (E rreme). ●

Vizuale

Shtojca

1

PERËNDIA thotë




Kjo është Fjala Ime

- Pse ta studiosh Biblën?
- Si ta studiosh Biblën

Këto janë standardet e mia

10 Urdhërimet
Eksodi 20:1-17



Krishti është Përgjigjja

- Hyjnia e Tij
- Jeta e Tij
- Vdekja e Tij
- Ringjallja e Tij

Cili është reagimi juaj?

- I shpëtuar
- Duke u rritur






Fuqishme
Romakëve 1:16

Dobishme
2 Timoteut 3:16

Personale
Psalmi 119:105


Praktike
Jakobi 1:22

Produktive
Marku 4:20



Lutuu

Zgjidh



Lexo



shqyrto



Pyet



Zbato

Mos
u shkurtajoni!



BIBLA

E

SHENJTË

Materialë për shpërndarje

Shtojca

2



PSË

ta studiojmë Biblën?

Përdorni simbolet për të zbuluar tetëmbëdhjetë fjalët

A	B	C	D	E	Ë	F	G	H	I	J	K
L	M	N	O	P	R	S	T	U	V	Y	Z

	_____		_____
	_____		_____
	_____		_____
	_____		_____
	_____		_____
	_____		_____
	_____		_____
	_____		_____

Tani i vendosni fjalët e gjetura në fjalitë e mëposhtme dhe gjeni pesë mësimet kryesore.

Ne duhet ta studiojmë Biblën sepse është vetë _____ e Perëndisë. Fryma e Shenjtë i _____ autorët që ata të shkruanin pikërisht atë që donte Perëndia. Megjithëse më shumë se _____ persona janë përfshirë, Bibla ka një _____ të mrekullueshëm. Zbulimet dhe përmbushja e _____ tregojnë se Bibla është e _____ . Pergamenat e _____ të Vdekur tregojnë se Bibla është _____ në mënyrë të jashtëzakonshme.

MUISQHFE

FJALA E PERËNDISË ËSHTË

REALOPNSE

TRPIAEKK

E EDBIOSMH

ERIKPVOUDT

Çfarë _____ i jashtëzakonshëm është të kesh Fjalën e Perëndisë! A i jeni bindur mesazhit të saj duke u _____ nga mëkati juaj dhe duke i _____ . Nëse po, atëherë ju nuk duhet vetëm ta lexoni Biblën por edhe t'i _____ asaj që thotë. Perëndia do ta _____ jetën tuaj dhe do t'ju bëjë _____ që Ai dëshiron të bëheni.

Fletë studimi biblik

Pasazhi: _____




Konteksti
i pasazhit:

Çfarë na mëson pasazhi mbi Perëndinë?
(Ati, Biri, ose Fryma e Shenjtë)



Çfarë mëson pasazhi mbi njeriun?
(Paralajmërim, premtim, urdhërim, shembull për të ndjekur)



Fjalë të vështira
ose figurative:

A ka pasazhe të tjera që mund të më ndihmojnë që ta
kuptoj këtë pasazh?



Perëndia dëshiron që unë të...